Sofoklis

Antigona

821.14'02-21 SOPH

SOFOKLIU

ANTIGONA

ENTI PËR BOTIMIN E TEKSTEVE
I REPUBLIKËS SOCIALISTE TË SËRBISË
B E O G R A D
1964

E përktheu
prof. S. PAPAHRISTO

BIBLIOTEKA E ... TIT
»HIV... «
Dega: për dërritur
Inv.: ~~30~~ 648

7738 - 50

Kët vepër e përgatiti për shtyp në gjuhën shqipe Reparti i Entit për botimin e teksteve i Republikës Socialiste të Sërbisë në Prishtinë

U shtyp në shtypshkrojën e Ndërmarrjes gazetare-botuese „Rilindja"
Prishtinë

HYRJE

„Antigona" është një nga tragjeditë më të mira, në mos më e mira tragjedi e Sofokliut, sikundër thonë disa filologë dhe kritikë. Ajo e mbuloi poetin me nderimet më të mëdha dhe me ofiqet më të larta. Kur u çfaq për herë të parë[1]) populli i Athinës — gjykatës i hollë i veprave dramatike — u enthuziazmua aqë shumë, sa që, përveç nderimeve të tjera, që i bëri Sofokliut e zgjodhi edhe strateg fuqiplotë në fushatën e Athinës kundër ishullit Samos. Përmbri tridhjetë herë u çfaq kjo dramë në Athinë dhe çdo herë poeti dilte prej theatrit i apoteozur nga publiku.

S'ka dyshim se ky triumf i detyrohet pikësëpari artit dhe zotësisë së poetit gjenial, i cili diti të thurrë këtë dramë me një mjeshtëri të rrallë; po edhe zgjedhja e subjektit kontribuoi në korrjen e këtij triumfi. Me të vërtetë, nji nga subjektet që interesoheshin në mënyrë të veçantë Grekët e vjetër, ishte dhe ay që merrej me detyrat ndaj të vdekurve. Asnjë tjetër s'qu-hej më e shenjtë, se sa plotësimi i detyrave kundrejt njeriut të vdekur. Prandaj ka qënë shumë i math interesimi i grekërve të vjetër për tragjeditë me një subjekt të këtillë. Po pikërisht plotësimi i detyrave ndaj një të vdekuri është ideja kryesore e kësaj tragjedije, subjekti i së cilës me pak fjalë është ky:

Poliniku, i biri i Edipit, mbretit të Tebës, erdhi me ushtri nga Argos kundër të vëllait Eteokliut, sepse ky i fundit kish rrëmbyer arbitrarisht fronin e t'et. Në betejën që u bë, ushtria e Argosit u thye dhe të dy vëllezërit në një dyluftim vranë njeri tjetrin.

Atëhere Kreoni që kish marrë frenat e pushtetit në Tebë, urdhëroi të varroset trupi i Eteokliut me tërë nderimet e zakonëshme, mbasi ky vdiq, duke luftuar për atdheun e tij kundër Polinikut tradhëtar dhe kundër një ushtrije të huaj; sa për trupin e Polinikut, me qënë se ky bashkët me një ushtri të huaj u turr kundër atdheut të tij, dha urdhër të mbetet i

---

1) Në vitin 441 p. e. r.

pa varrosur, në mënyrë që të copëtohet dhe të hahet prej qenjve dhe shpendëve. Të dy motrat e Polinikut, Antigona dhe Ismena, vajtojnë për këtë fat të keq të vëllait të tyre, me gjith'atë, Ismena është e mendimit dhe këshillon të motrën që t'i binden urdhërit të Kreonit. Antigona përkundrazi, një vajzë guximtare dhe trime, vendos të varrosë të vëllanë, duke shkelur urdhërin e panjerëzishëm dhe duke përbuzur çdo rrezik, që mund të sillte një veprim i këtillë nga ana e saj. Ndjen edhe vetë se nuk është në rregull me ligjet e pushtetit, po me gjith'atë preferon të veprojë sipas ligjit moral të pashkruar, i cili, u impononte disa detyra njerësve që ishin farefis i të vdekurit. Kreoni kokëfortë dhe i paepur, urdhëron të vritet Antigona, e fejuara e të birit, Emonit. Shortari Tiresia e paralajmëron për gjithë të zezat që do t'i sjellë zemra e tij prej guri; nga këto paralajmërime tronditet Kreoni dhe mundohet të ndreqë gabimin, po është vonë. Fati nuk vepron me vonesë. Mbi varrin e Antigonës Emoni vrau vehten; më pas Euridiqi, gruaja e Kreonit, u var kur mësoi të keqen e djalit të saj. Kreoni më në fund vjen në vehte dhe pendohet, po është tepër vonë.

*

Kështu pra shpjegohet enthuziazmi i math që pushtoi spektatorët kur panë se një vajzë guxon të shkelë urdhërin e panjerzishëm të një tirani dhe të plotësojë detyrën e sajë ndaj vllait të vdekur, duke varrosur trupin e tij. Trimërija shpirtërore dhe guximi i jashtëzakonshëm i Antigonës tërheqin admirimin dhe simpathin 'e spektatorit. Fjalët e saj, argumentat e forta që përdor gjatë bisedës me të motrën dhe me mbretin Kreon, më në fund vajtimet dhe përshpëndetjet prekëse, që bëri para se të mbyllej në varr e gjallë, të gjitha këto të prekin aq thellë, sa që nuk mund t'i mbash lotët.

Zhvillimi i subjektit bëhet mę një gjallëri e qartësi, që s'i gjen në asnji nga tragjedit 'e tjera të poetit. Spektatori, posa hapet skena, hyn menjiherë në thelbin e subjektit dhe aty për aty formon një ide të qartë mbi zhvillimin e tij dhe mbi karakteret e personave të ndryshëm që dalin në skenë. Një dialog i shkurtër dhe i shpejtë të fut brenda në temë, pa qënë nevojë për prologe të gjata, si ato të Euripidit. Kori që çfaqet në skenë pas bisedës së shkurtër midis dy motrave, Antigonës e Ismenës, në vend që të përsëritë në mënyrë të thatë zhvillimin e ngjarjeve në Tebë d.m.th. shpëtimin e qytetit dhe vrasjen e të dy

vëllezërve, përshëndet me një hymnë madhështor fitoren e atdheut dhe me pak fjalë vetëm le të kuptohet qëllimi që e solli në skenë.

Kreoni mundohet ta mbështetë urdhëresën e tij të rreptë mbi argumenta sofistike, si ato që përdorin njerëzit e kategorisë së tij d.m.th. njerëzit krenarë dhe brutalë. Thotë me plot gojën se i thirri pleqtë nga Teba, për t'u këshilluar gjoja me ta; mirë po kjo është një maskë që përdori për të mbuluar vendimin e tij të egër, se kur mblodhi këshillin e pleqve, vendimi ishte marrë dhe urdhëresa kishte dalë.

Ngjarjet zhvillohen më një ritmë të shpejtë. Shkelet urdhëri i lëshuar prej mbretit. Trupi i Polinikut varroset. Fajtori nuk zbulohet. Kokëfortësija e Kreonit arrin kulmin. Më në fund zbulohet fajtori dhe sillet në skenë. Është Antigona. Sa kundërshtim i math në mes të karakterit të egër të Kreonit dhe gjakëftohtësisë, guximit e trimërisë së vajzës.

Me pohimet e Antigonës kujton spektatori, se puna është në mbarim e sipër. Fajtori u zbulua; e pohoi fajin; Kreoni qëndron i paepur. S'mbetet tjetër përveç se katastrofa. Po ja disa ngjarje të reja që vinë njera pas tjetrës; këto ngjarje me njërën anë pezullojnë dhe vonojnë katastrofën, e më anën tjetër krijojnë në shpirtin e spektatorit gjendjen e pritjes e të dyshimit, si ato që lakmon së tepërmi Sofokliu. Çfaqet Ismena dhe deklaron se edhe ajo është fajtore, e pra edhe ajo duhet dënuar. Një gjë e këtillë e papritur sjell një farë ngatërrese në shpirtin e Kreonit. Me gjithë këtë qëndron i paepur dhe ngul këmbë në zbatimin e ligjit. Mënyrën e vdekjes akoma s'e ka caktuar dhe mendimet që çfaq aty këtu në kohën kur këndon kori, të lenë të besosh se mbi këtë pikë s'ka marrë edhe vendim të prerë.

Çfaqet edhe një tjetër person: Emoni, i biri i Kreonit dhe i fejuari i Antigonës. Paraqitet ky me një modesti që i ka hije një djali të ri. Besoi se me anën e kësaj modestije do të mundë të zbutë zemrën e egër të Kreonit. Po në vend që ta zbutë, e egërson më shumë. Vendimi që mori mbreti, do të ekzekutohet sa më parë. Antigona do të vdesë pa tjetër.

Po spektatori; pa u çlodhur akoma mirë, preket e goditet prej mallëngjimesh të reja: Antigona dërgohet për t'u varrosur e gjallë; me një monolog të lartë shpreh gjith'ato ndjenja, që mund t'i kallë nji vajzë të re dashuria ndaj vëllait të saj, ndaj atdheut e ndaj viseve të tij të bukura dhe më në fund hidhërimin që ndjen, se po e le jetën aq e re . . .

Kreoni qëndron i paepur. Ndërhyrja e Tiresiut dhe prestigji që gëzon ky si shortar plak, i japin shpresa spektatorit. Më

kot; këshillat e shortarit nuk e bindin Kreonin. Më në fund profetirat dhe paralajmërimet e tmershme të Tiresiut e tronditin fort Kreonin. Kërkon ta ndreqë gabimin; mirëpo është vonë; fati i bije si një rrufe. Fatkeqësira të tmershme e goditin njera pas tjetrës: i biri vret vehten brenda në varr të Antigonës; e ëma e Emonit i jep fund jetës në mënyrë tragjike, varet.

Kështu pra dënohet mbreti për kokëfortësin' e tij të pakufishme. Ay që gjer dje tmeronte botën, tani s'është tjetër gjë veçse një kufomë e vërtetë. Më në fund vë mënd, po është tepër vonë.

*

Nga ana artistike është për t'u theksuer veçan zotësija psikollogjike e poetit; njeh ky shpirtin e njeriut me tërë lëkundjet, pasionet dhe dëshirat e tij, si edhe influencën që ushtrojnë këto mbi fatin e njeriut. Provë të qartë të kësaj zotësije, përveç të tjerave, na jep edhe hymni i famëshëm i dashurisë:

„Dashuri që gjithmonë
nukë thyhesh ndër betejat
. . . . . .
ti që shkon në mal' e stane
. . . . . .
s'le pa prekur, pa goditur
të pavdekshmit perëndi
si dhe njerëzit ditshkurtër
dhe ay që ke pushtuar
bën tamam si një i çmëndur"



Edhe hymni që i thur fuqisë mendore të njeriut, tregon mëndjen gjeniale dhe largëpamëse të Sofokliut:

„Bota ësht plot çudira,
po çudia më e madhe
nga të gjitha ësht njeriu;
ky, kur era fryn furishëm,
detin çan të shkumbëzuar,
duke shkuar nëpër valët
që buçasin an' e mbanë.
. . . . . .

Ky ka gjetur mjet shpëtimi
nga sëmundjet for të rënda;
vdekjen vetëm nuk e mundi
as që do ta mundë kurrë"

Kjo zotësi e Sofokliut shihet kudo: në thurjen e subjektit në përshkrimin e ngjarjeve, në vizatimin e personave, në paraqitjen e kontrasteve, në luftimet e brëndëshme të shpirtit, në përpjekjet e ndjenjave të kundërta etj. Gjithashtu karakteret e personazheve, dhe veçan ay i protagonistes, ashtu siç paraqiten prej poetit, ushtojnë influencë të madhe mbi shpirtin e spektatorit dhe pjesa dialogjike dhe ajo lirike pasurohet e zbukurohet me mendime të larta morale, politike, e patriotike. Të gjitha këto tregojnë arsyen pse kjo tragjedi ka ngjallur dhe vazhdon të ngjallë admirimin e botës së qytetëruar.

Prof. S. PAPAHRISTO

PERSONAT E DRAMËS

ANTIGONA, ISMENA — bijat e Edipit
KORI (i përbërë prej 15 pleqsh nga Teba)
KREON-i
ROJTARI
EMON-i
TIRESIA (shortari)
LAJMËTARI
EURIDIQI

Çfaqja bëhet në Tebë përpara pallatit të Kreon.t

A K T I

S k e n ë e p a r ë

(Antigona — Ismena)

ANTIGONA

Ismena e dashur, shpirt i shtrenjt' i motrës!
Nga ato të zezat q'erdhnë prej Edipit,
ti a di ndonjë që s'dërgoi Zeusi
mbi ne q'edhe rrojmë? S'ka vërtet as dhëmbje,
as fatkeqësi, as turp, as përbuzje
që nukë kam parë ndër vuajtjet e tua
dhe n'ato të miat. Prapë sot, si thonë,
ç'urdhër tani shpejt shpalli kryetari
për gjithë banorët e këtij qyteti?
A di? A dëgjove? A po s'merr dot vesh
se ç'gatit armiku mbi kurriz të miqve?

ISMENA

Mua, Antigonë, për njerëzit tanë
asnjë lajmë s'm'erdhi, e mir' a e hidhur,
që ahere kur dy vëllezërit tanë
vranë njeri tjetrin të dy në nji ditë.
Dhe tani q'ushtria e Argive iku
natën e kaluar, nukë di gjë tjetër
që ta quaj vehten ose më të lumtur
ose më fatkeqe.

ANTIGONA

Këtë un' e dinja, e prandaj të thirra
të dalësh përjashta portës së oborrit,
mbasi vetëm ti duhet t'i dëgjosh.

ISMENA

Ç'është? Se më dukesh që mendon diçka
që të turbullon.

ANTIGONA

Nga të dy vëllezërit, njerin e nderoi
me varrim Kreoni, kurse tjetrin jo!
Për Eteoklinë thonë se dha urdhër,
që në dhe të kallet si e do e drejta,
ligjet e zakonet e qytetit tonë,
me qëllim q'ay të jet' i nderuar
ndër ata që vdiqnë dhe ndodhen te Hadi.
Kurse për të shkretin Polinik q'i ra
mortja e shkretuar, shpalli në qytet
që asnjë qytetas të mos e varrosë
as të mos vajtojë, as të mos qajë,
po mbi dhe ta lënë, si ushqim të ëmbël
për zoqtë që gjuajnë të gjejnë ushqim.
Ja këto, si thonë, shpall Kreon' i mirë
për ty e për mua-dëgjon? — dhe për mua;
vjen këtu dhe vetë, që ta thotë qartë
për gjithë ata që s'kanë dëgjuar.
Dhe s'ka fjalë vetëm; po kush do të bëjë
ndonjë nga këto, do vritet me gurë
brenda në qytet. Ja kështu ësht puna.
Tani do tregosh, në se je fisnike,
apo frikacake, ndonëse prej prindësh
të dëgjuar rrjedh.

ISMENA

Po në qofshin punët kështu, moj e shkretë,
si do që të bëj, ç'dobi do të dalë?

ANTIGONA

A do më ndihmosh? Ja mendohu pak.

ISMENA

Për ç'rrezik gatitesh? Ç'ke ndërmend të bësh?

ANTIGONA

Kësaj dorës s'ime a do të i ndihesh,
që të ngremë trupin e vëllait tonë?

ISMENA

Mendon ta varrosësh dhe të shkelësh urdhërin?

ANTIGONA

Vëllan tim dhe tëndin, edhe në mos daç;
unë tradhëtore e vëllait tim
kurrë nuk do bëhem.

ISMENA

Po, moj, korbë, kundër urdhërit të Kreonit?

ANTIGONA

Nukë ka të drejtë, që të mos më lërë
të nderoj të mijtë.

ISMENA

Oh motër e dashur! Pa e sill ndërmënt
se si at' i shkretë, kur kuptoi mëkatet
vdiq në mes të tmerit, i urrejtur fort,
dhe me duart e veta nxori syt' e tij!
Si pastaj e shoqja, q'e pat edhe nënë,
jetës i dha fund, u var në litar!
Si në fund vëllezërit ranë që të dy,
në një dit të mjerët vranë njeri tjetrin!
Tani në të shkretat, merre pak me mënt,
sa keq do mbarojmë, në se kundër ligjit
do të shkelim urdhërin e tiranit t'fortë.
Më në fund kuptoje, se ne jemi gra
dhe natyra vetë nukë na ka bërë
të luftojmë burrat; pastaj mbasi ne
na sundojnë njerës shumë më të fortë,
duhet të dëgjomë jo vetëm këto'
po edhe të tjera edhe më të hidhura.

ANTIGONA

Nukë po të vihem, dhe në daç më vonë
të më japësh ndihmë, nuk do më kënaqësh,
Bëj pra si të duket, si të të pëlqejë.
Un' atë pa tjetër do ta kall në dhe;
po ta bëj këtë, do vdes e nderuar.
Do të prehem pranë atij që më do,
atij që e dua; do të bëj një krim,
po një krim të shenjtë; është m'e gjatë koha
që do t'u pëlqej atyre të Hadit,
se atyre q'janë këtu përmbi dhe,[1])
se atje gjithmonë do të rri e shtrirë.
Ti, në të pëlqeftë, përbuzi ato
q'i çmojnë dhe hyjtë.

ISMENA

Unë s'i përbuz, po kundër qytetit
edhe qytetarëve nuk mund të veproj.

ANTIGONA

Ti këto përdori si ndonjë pretekst;
Unë do të shkoj të varros vëllanë,
një vëlla të shtrejtë.

ISMENA

Medet un' e mjera! Sa trembem për ty!

ANTIGONA

Mos u tremb për mua; mendohu për vehte.

ISMENA

Këto as njeriut të mos ia thuash,
po ta mbash të fshehur; sikundër dhe unë
do ta mbaj të fshehur.

---

1) D. m. th. preferoj t'u pëlqej të vdekurve, bashkë me të cilët do të rri një kohë më të gjatë (për gjithë jetën), se sa të gjallëve, me të cilët do të qëndroj një kohë të shkurtër.

ANTIGONA

Jo, duhet të flaç; do të të urrej
edhe ca më shumë, po s'i the kudo.

ISMENA

Ndërsa ti po nxehesh, unë jam gjakftohtë.

ANTIGONA

Se kështu kënaqen bash ata që duhet.

ISMENA

I arrifsh qëllimit; po ti merr përsipër
gjëra që nuk bëhen.

ANTIGONA

Do ta nis njëherë
e më pas në s'mundësha, kam për t'hequr dorë.

ISMENA

Gjera që s'i bën, fare mos i nis.

ANTIGONA

Me këto që thua më helmon dhe mua,
— e me plot të drejtë — dhe atë që vdiq.
Lermë pra të vuaj, lermë, lermë të pësoj,
si më këshillon koka im' e thatë;
si do që të ngjasë, do të vdes me nder.

ISMENA

Kur t'u mbushka mëndja, shko për ku u nise;
dije se gatitesh të veprosh pa mënd;
po të jesh e sigurtë, se ata q'i do,
do t'të duan prapë[1]).

[1]) Dalin të dy motrat dhe hyn kori, i cili përshëndet djellin që sa po lindi.

Nr. Invent. 22545

Skenë e dytë

KORI *(duke hyrë në skenë)*

Strofë I.

O rrez' e djellit,
drita m'e bukur,
q'u duk ndonj'herë
gjer sot mi Tebën
me shtatë porta!
Na ndrite pra,
o sy çkëlqenjës,
i ditës s'artë
duk' ardhur sipër
nga kroi Dirke;
edhe ushtrinë
q'u turr nga Argos
e armatosur
m'ato mburoje
plot me shkëlqim,
e bërë t'ikë
me thembrat prapa
dhe me të katra;
atë ushtri
q'u turr e ndezur
nga pretendimet
e Polinikut,
q'u sul furishëm
dhe ra mbi tokë
musi shqiponjë,
duke i hapur
krahët e bardha
musi dëbora
me shumë armë
dhe përkrenare
prej qimesh kali.

Antristrofë I.

Erdh, qëndroi mbi qytetin
plot me shtiza gjakatare
dhe gatitej t'i ngulte
munë gojën shtatëvrimshe.[1])
Porse iku dhe u-çduk,
pa e mbushur, pa e ngopur
gojn' e tij me gjakun tonë,
edhe pa u vënë zjarr
pishave që të përhapin
flagën në kështjellat rrotull.
Prap' a tyre u dëgjua
britm' e madh' e hyjit Ari
që e bëri ky draguan[2])
të pathyer prej armiqve.

Se Zeus-i i urren
mburrjet, fjalët e mëdha;
dhe kur pa se u vërsulnë
si një valë e tmeruar
dhe se mburreshin me armët
e stolisura me ar,
me rrufenë e rrëzoi
atë që u ngjit në mur
dhe që ish gati tia merrte
këngës, hymnit të fitores.

---

[1]) Teba quhet „shtatëvrimëshe" se kishte shtatë porta.

[2]) „Draguan" d.m.th. Tebanët.

Strofë II.

U lëkund e ra për dhe
burri që u turr mbi ne,
duke mbajtur zjarr në dorë
tamam si njeri i dehur
me një hov si i tërbuar,
si një erë e furishme,
Po i dolli ndryshe puna;
Ari, hyji fuqimadh
që s'ndan fatet barabar,
krah për krah me ne luftoi
dhe e ndoqi tej armikun.

Shtatë kapedanë
erdhn' e zunë vënd
në të shtatë portat
kundër shtatë shefash
të qytetit Tebë;
mirë po ata
iknë dhe i lanë
armët e bakërta
si trofe Zeusit.
Mbetnë vetëm dy
oh! dy të mjeruar,
që ishin vëllezër
prej një nën' e atë,
Me shtizat në dorë
që të dy u turrnë
njëri kundër tjetrit;
aty për aty
vret vëllau vëllanë.

Antristrofë II.

Po ja se ku na erdhi
fitorja e lavdishme
dhe Tebës plot me qerre
i solli gas të madh;
harrojini pra luftërat
që kishim gjer më sot
dhe ejani ta gdhimë
me këngë dhe me valle
rreth tempujve të hyjve
me Bakhusin në krye
që tund qytetin Tebë.

Ja ku vjen Kreoni
bir' i Menikeut,
q'u bë rishtas mbret
i kësaj toke
me dëshirë t'hyjve.
E ç'mendohet vallë?
Për ç'qëllim i thirri
këtu gjithë pleqtë?

(Hyn Kreoni)

Skenë e tretë

(KREONI — Kori)

KREONI

Perëndit' o burra përsëri shpëtuan
Tebën që e tundi një stuhi e madhe.
Prandaj ju lajmova dhe nga qytetarët
ju vetëm ju ftova gjer këtu të vini,
sepse e di mirë sa respekt treguat

ndaj fronit të mbretit e kundrejt pushtetit
kur në fron ish Lai dhe më von' Edipi;
Po edhe pas vdekjes së këtij të fundit
besnikë qëndruat karshi djemve tij.
Po tani që humbnë që të dy këta,
duke vrarë njeri tjetrin në një ditë
me duart e tyre, duar mëkatare,
un' i marr në dorë frenat e pushtetit,
se jam unë vetë fis e gjak i tyre,
Vërtet ësht' e zorshme të kuptosh mendimet,

shpirtin edhe ndjenjat e kujtdo njeriu,
para se të shohësh se si ky ushtron
ligjët e pushtetin që i ka në dorë.
Se pas mëndjes s'ime, ay që drejton
fatet e një shteti, në s'dëgjon mendimet
q'janë më të mira dhe nga frik' e madhe
gojën nuk e çel, ky për mua është
një njeri i dobët, jo vetëm tani
po edhe nga hera; dhe ay njeri
që i do më shumë miqtë se atdheun,
unë këtë, besa, as e ve në numur;
sepse kurrë gojën nukë do ta mbyll
— dëshmimtar më qoftë Zeusi gjithshëkues —
sa herë do shoh se një gjë e keqe
turret mi qytetin, që t'ia rrëmbejë
lumturin' e jetën; kurrë prap atë
q'ësht' armik i shtetit, s'do ta bënja mik,
sepse e di mirë që shpëtimin tonë
i a detyrojmë shtetit e atdheut;
edhe kur ania e tyre lundron
krejt e siguruar, gjithë botën ne
do ti kemi miq.
Ja këto pra janë ligjet me të cilat
unë do përpiqem ta drejtoj qytetin;
mi këto u mbështeta edhe nxora urdhër
nëpër qytetarët për djemt e Edipit.
Për Eteoklinë që luftoi gjithmonë
si një trim me fletë për atdhen' e tij
dhe që më në fund fli u bë për 'të,
nxora urdhëresë të varroset mirë,
me ato nderime që i kanë hije
atij luftëtari që vdes për atdhe.

Sa për Polinikun, për vëllan' e tij,
q'erdh nga internimi kundër këtij vëndi,
kundr' atdheut tij dhe të atit tij,
me qëllim të digjte tempuj e qytet,
racës tij t'ja thithte gjakun sa të ngopej
edhe ju të gjithë rob' e skllav t'ju bënte
për këtë pra çpalla që të mos varroset
dhe asnjë qytetas ta vajtojë, ta qajë,
po mi dhe të mbetet dhe i pa varrosur
që ta hanë qenjtë edhe shpendët bashkë
e që kush ta shohë të i ngjethet mishtë.
Ja pra ç'kam vendosur; se të paktën unë
të këqinjtë kurrë nuk do t'i nderoj
barabar me njerëzit që janë të mirë.
Po ay që është mik i shtetit tonë,
ky prej anës sime ka për t'u nderuar
e sa ësht' i gjallë, edhe si të vdesë.

KORI

Sjellja jote, Kreon, bir i Menikeut,
që do mbash ndaj miqve edhe ndaj armiqve
të qytetit tonë, është e pëlqyer.
Ti sipas dëshirës, mund të çpallësh ligje
dhe për ne të gjallët edhe për të vdekurit.

KREONI

Shihni pra ky urdhër të zbatohet mirë.

KORI

Këte barrë vërja ndonjë më të riu.

KREONI

Unë kam dërguar
njerës për të ruajtur trupin e të vrarit.

KORI

Ç'tjetër gjë ahere na ngarkon të bëjmë?

KREONI

Ju të mos i falni ata që do shkelin
urdhërat e mia.

KORI

S'ka njeri të çmëndur që të dojë vdekjen,
se pa fjalë vdekja është' ajo q'e pret.
Mirpo shumë veta deri edhe sot
shpresa për fitime i mori në qafë.

Skenë e katërtë

(Kreoni—Kori—Rojtari)

ROJTARI

O Mbret! nga nxitimi — s'dua të ta thom —
këmbët dhe s'më zunë, fryma ment m'u muar;
sepse gjatë rrugës or' e ças më vinin
shumë lloj mendimesh që më detyronin
të qëndroj në rrugë, këmbët të i mbaj,
të vendos shpesh herë që të kthehem prapa;
shpirti im që brënda, si edhe një zë
më jepte këshilla, më thoshte kështu:
„O njeri i mjerë! Pse po shkon atje,
ku të pret dënimi? Prap po rri fatzi?
Sikur të të shohin e t'ja thonë mbretit,
ç'ke për të pësuar, ti, ore i shkretë?"
Ja këto më vinin or' e çast në mënd
dhe me bënin t'ecnja fare me ngadalë
e kështu kjo rrugë na u bë e gjatë,
ndonse vetvetiu është mjaft i shkurtër.
Më në fund vendosa të vij pranë teje
dhe të flas me ty, ndonse gjë s'po them.
Vij vërtet me bindjen që gjithnjë kam patur,
se dhe në pësofsha, do pësoj atë
që më ka caktuar, që ka shkrojtur fati.

KREONI

Ç'është, more, ç'ësht? Pse të kallka tmer?

ROJTARI

Më përpara dua të të flas për vete:
Unë s'e kam bërë, kush e bëri, s'di;
kështu s'ësht' e drejtë të pësoj gjësendi.

KREONI

Bukur, shumë bukur, punën e vërtit,
sillesh rreth e rrotull, dhe flet larg e larg,
kërkon si të ruhesh, të shpëtosh lëkurën;
besa, duket sheshit se ke për të thënë
ndonjë gjë të madhe.

ROJTARI

Lajmet e këqia nuk guxon ti thuash.

KREONI

Hajde! hap-e gojën; e pastaj qërohu.

ROJTARI

Ja pra po të them:
Dikush e varrosi trupin e të vrarit;
hodhi kum të thatë, bëri gjithë ritet.
dhe pastaj u-zhduk.

KREONI

Si or si? çfar' thua? Kush pati guxim?

ROJTARI

S'e di, besa fare; sepse aty toka
as me ndonjë bel s'ishte e goditur
as me ndonjë shatë nuk ishte rrëmyer,
po ka qen' e thatë tamam si një gur;
s'kish ndonjë të çarë, s'dukej gjurmë qerresh
e prandaj s'kuptohet kush qe guximtari.
Kur rojtar' i parë i asaj dite
solli këtë lajm, një çudi e madhe
na erdhi të gjithve sepse trupi s'dukej,
po dhe i varrosur nukë ish tamam;

Por mi varrin vetëm një pluhur të hollë
kishte hedhur dikush, me qëllim, si duket,
të shpëtojë veten prej këtij mekati.
Shënja s'kishte fare që të na tregonin
se aty kish ardhur qen a kafshe tjetër,
për të nxjerrë trupin, për ta copëtuar.
Nismë nga të sharat njëri kundër tjetrit;
Rojtarët qërtonin rreptë njeri tjetrin;
për pak do kërciste druri edhe shkopi
dhe asnjë nuk ishte që të na përmbante
S'kish dyshim se punën një prej nesh e bëri
po mungonin provat; gjithë thoshnin „jo".
Bënim be të gjithë, bile gati ishim
të zinim me dorë hekura të nxehta,
dhe të thoshnim se nuk e bëmë ne,
po dhe kush e bëri nuk e dinim fare.
Kur pamë se fundi se, s'po nxirnim gjë,
një nga shokët tanë hedh në mes një fjalë
që na prishi mëndjen; nga llahtara bile
gjithë ulmë kryet, goja na u zu,
sepse s'ish e mundur që të thoshnim „jo",
po dhe „po-ja" kishte një rrezik të madh.
Tha pra shoku ynë që në këtë ngjarje
të mos e mbulonim, po të ta tregonim
ashtu si kish ngjarë; gjithë thamë „po".
Shorti ra mbi mua që ta bëj këtë
mision të bukur; ja pra t'erdha pranë
ndonëse kjo punë s'na pëlqen të dyve,
se ata që sjellin lajme të këqia
askush nuk i do.

KORI

Madhëri!
Mua që prej kohe m'është mbushur mëndja
se kjo ngjarj'e sotme s'është veçse shënjë
që na vjen nga hyjtë

KREONI

Mos folë! mbyll gojën! Se më mbush me vrer;
e provon ti vetë se më qënke plak,
edhe truri yt të ka rredhur fare.
Vërtet nuk durohen gjith'ato që thua,
që guxon të thuash se kujdesen gjoja

perënditë vetë për këtë q'u vra.
Mos vall u kujdesnë që ta shtjen në varr
edhe ta nderojnë si njeri të mirë,
këtë që na erdhi me qëllim të djegë
tempuj dhe statuje dhe të prishë ligjet?
A beson se hyjtë të liqt i nderojnë?
Jo; nuk është puna si e thua ti.
Po ca qytetarë këto s'i durojnë
dhe përhera flasin fshehtas kundër meje
edhe pështpëritin duke tundur kokën;
këta nukë duan që të ulin qafën
nënë zgjedhën time, as të respektojnë
— si e do e drejta-urdhrat që lëshoj.
Jam pra krejt i sigurt se parat' e tyre
shtynë disa njerës që ta shtjen në dhe.
Se nga gjithë gjërat që gjeti njeriu,
çpikja e parasë është më e keqe.
Kjo rrenon qytete, kjo shkreton shtëpira,
kjo dhe një të miri mëndjen i a merr
dhe e shtyn të bëjë punëra të liga.
Njerësv'u tregoi shumë dhelpërira
edhe u mësoi plot padrejtësira.
Po ata q'e kanë bërë këtë punë
se kështu i shtyri forca e parasë,
le ta dinë mirë se e vranë veten.
Unë në kam edhe respekt për Zeusin
dij-e fare mirë dhe po të betohem,
se në mos tregofshi kush është fajtori
e në mos e sjellçi atë para meje,
vdekja s'ësht'e mjaftë si dënim për ju,
po ju që të gjithë do t'ju var të gjallë
gjer sa të rrëfeni kush e bëri fajin;
kështu do të merrni një mësim të bukur:
të mos ndiqni kurrë as ndonjë fitim
as me të rrëmbyer as me të grabitur,
të mos e lakmoni me çfardo mënyrë,
në çdo rast e kohë.
Se ke për të parë që prej ca fitimesh,
fitimesh që bëhen pa nder e pa cipë,
me të shumtët njerës s'dalin faqebardhë,
po përkundër prishen, shuhen, çkatërrohen.

ROJTARI

A do të më lesh
që të flas akoma, a t'ja mbaj nga erdha?

KREONI

A s'ke marrë vesh se edhe tashti
më mërzit së tepri me ato
që thua?

ROJTARI

Shpirtin ta thumbojnë, apo vetëm veshët?

KREONI

Ç'thua, more ç'thua?
Si guxon të pyeç ku e paskam dhëmbjen?

ROJTARI

Ësht fajtori vetë që të lëndon zemrën,
kurse fjala ime të vret vetëm veshin.

KREONI

Dukesh prej natyre llafazan i madh.

ROJTARI

Unë jo, për besë! punën s'e kam bërë.

KREONI

Ti për ca të holla edhe shpirtin shite.

ROJTARI

Medet!
Sa i tmershëm ësht dyshimi i rremë!

KREONI

Zbukuro, o burrë, sa të duash fjalët;
zbukuro shpotitë që lëshon nga goja;

unë edhe nj'herë ja ku po ju thom:
po të mos rrëfeni kush e bëri fajin,
kam për t'ju shtrënguar që të thoni vetë,
se fitimi'i turpshëm sjell fatkeqësira.

ROJTARI

Dashtë perëndia të gjëndet fajtori!
Si do qoftë puna, u gjetka, s'u gjetka,
— se kjo punë është në dorë të fatit —
s'ke për të më parë që të kthehem prapa.
Po me që shpëtova pa shpresuar fare,
tepër mirënjohës u jam perëndive.

(Del rojtari)

KORI

Strofë I.

Bota është plot çudira,
po çudi më e madhe
nga të gjitha ësht'njeriu:
ky, kur era fryn furishëm,
detin çan të shkumbëzuar,
duke shkuar nëpër valët
që buçasin an'e mb'anë:
ky dhe Tokën më të lartër
dhe nga perënditë vetë,
që s'po lodhet e s'po prishet,
vit për vit e përpunon
m'anë mushkash edhe kuajsh.

Antristrofë I.

Bash ay ësht mëndje-dreqi
që me rrjet' e pezaule
edhe shpendët mëndje-lehta
I rrethon edhe i ze
dhe kopenjt me kafshë t'egra,
si dhe gjith'ato që rrojnë
nëpër thellësit'e detit;
m'ato çpikje që ka bërë
posht i vë dhe i sundon
kafshë t'egra që banojnë
nëpër male, nëpër pyje;

edhe kalin e shtrëngon
t'ulë qafën qimegjatë
nënë zgjedhën dykulare,
si nga lodhja s'do t'ja dijë.

Strofë II.

Vetë ky e ka mësuar
artin si të kuvendojë,
si të gjejë, të çfaq mendime,
q'jan të shpejta mu si era,
të vendos'e të ve ligje,
për të mbrojtur një qytet;
si e si të ruajë vehten
nga shigjetat e këqia
të dëborës e të shiut,
edhe brenda në oborr,
gjithashtu edhe përjashta.
Për çdo gjë e gjen mjetin
dhe mendimi s'i mungon
as për gjërat e së ardhmes.
Ky ka gjetur mjet shpëtimi
nga sëmundjet fort të rënda;
vdekjen vetëm nuk e mundi
as që do ta mundë kurrë.

Antristrofë II.

I pajisur me fuqi
të çpik'arte, mjeshtërira,
herë merr të keqen rrugë
herë prap atë të mirën.
Shpesh përzien, ngatërron
ligjet e kësajë bote
me të drejtat hyjnore,
kur drejton ndonjë qytet.
Po ky mbetet krejt pa vlerë,
kur merr rruga të këqia
në të cilat fort'e shtyn
nje guxim të tepëruar.
Kush bën punëra të tilla,
me mua mos pastë kurrë
as banesë të përbashkëtë,
as mendime të njëllojta.!

A K T II

S k e n ë e p a r ë

(Kori — Antigona — Rojtari)

Hyn rojtari duke sjellë Antigonën

KORI

Mos ësht' hije hyjnore
ajo që po shoh tashti?
Si të thom — kur jam i sigurt —
se kjo s'është Antigona?
Oh, e shkreta Antigona,
bij e mjerë e Edipit,
atit shumë të mjeruar!
Vallë çfar po ngjet kështu?
Mos të sjellin ty këtu,
se s'ju binde urdhërit t'mbretit?
Mos të zunë kur po bënje,
ndonjë punë krejt pa mënd?

ROJTARI

Ja kjo ësht fajtorja! Kjo e shkeli urdhërin;
vëllanë varrosi; po ku ësht Kreoni?

KORI

Ja del nga pallati, del në çast që duhet.

Skenë e dytë

(Hyn Kreoni)

KREONI

Ç'është, more ç'ngjet?
Ç'është kjo që thoni: „vjen në çast që duhet"?

ROJTARI

Mbret! Njeriu kurrë
s'duhet të betohet; sepse shumë herë
një mendim i dytë e rrëzon të parin;
ja për shëmbëll unë! Nga ty i tmeruar
bëra be, vendosa, të mos kthehem prapë.
Mirë po gëzimi që vjen pa e pritur;
s'mund të barabitet me asnjë dëfrim.
Ndonse u betova të mos kthehem më,
ja ku erdha prap duke sjellë me vehte
edhe këtë vajzë, që e zumë befas,
kur po bënte gjithë ritet e varrimit.
Unë këtë radhë nukë prita short,
po me vrap u nisa, sepse ish i imi
ky zbulim i sotmë. Dhe tashi, o mbret,
merr-e këtë vajzë, që po e kërkonje,
pyet-e, gjykoj-e, bëj-e si të duash.
Edhe sa për mua është krejt e drejtë
të lirohem fare nga çdo lloj kujdesje,
të shpëtoj dhe kokën nga çdo far rreziku.

KREONI

Pa më thuaj pak:
Si e zure vajzën dhe nga ç'vënd e sjell?

ROJTARI

Po varroste trupin; ja i di të gjitha,

KREONI

A i merr vesh mirë fjalët që më thua?

ROJTARI

Kjo varrosi trupin kundër urdhërit tënd;
a s'janë të qarta këto që po thom?

KREONI

More, a s'më thua:
Si e patë vallë? si e kini zënë?

ROJTARI

O Mbret!
Ja si ngjau puna: të tmeruar ne
nga kanosja jote, pik së pari shkuam
gjer të vend' i varrit dhe e fshihmë mirë
pluhurin e dhene q'ishte për mi' të;
pastaj që nga varri e nxuarm' e ç'veshmë
trupin që sapo kish zënë të tretej.
Me vrap u larguam dhe në kodrat afër
shkuam e qëndruam në një vënd aty
ku nukë e zinte er' e pa duruar
që lëshonte varri. Nxitnim njëri tjetrin
që të rrinim zgjuar, se do ta pësonim,
po të mos e bënim punën që na the.
Këtu pra po rrinim, gjer sa djell' i ndritur,
si përshkoi eterin, mu në mes të qiellit
ndenji dhe qëndroi. Vapa po na digjte,
kur nga toka befas dolli një tufan,
një poter' e egër, një gazep qjellor,
q'u përhap në fushë: shelgjet po i çvishte
gjer në qjell e shpinte, lartë në eter,
pluhurin që ngriti nga të gjitha anët;
ne me sy të mbyllun prisnim të kalojë
ky mallëkim i qjellit, ky tufan i tmershëm
që, si shko një kohë, më në fund u pre.
Bash ahere dolli kjo vajzë këtu
dhe lëshoi klithmë, e një zë të fortë,
si ay që nxjerrin shpendët kur s'i gjejnë
vegjëlin' e tyre brenda në fole,
në fole që mbetet fare e shkretuar.
Gjithashtu dhe vajza kur e pa kufomën
të zbuluar fare, ia krisi vajit,
mallëkoi nga shpirti gjith ata që
bënë këtë punë shumë të shëmtuar.
Merr nga toka dhe, i a hedh kufomës
e mbulon këtë

dhe me stomnë remi të punuar mirë
tri her' e spërkati, libatoi tri herë
Ne, posa e pamë, rendmë që të gjithë
dhe e zumë, vajzën; kjo s'u drodh as fare,
nukë u pendua për atë që bëri,
as dhe për të tjerat që i kishte bërë.
Vajzës rënd, i folmë; kjo nuk i mohoi,
i pranoi përkundër gjithë sa kish bërë,
gjë që na gëzoi, po dhe na helmoi.
Eshtë gas pa fjalë të shpëtosh lëkurën,
po edhe helmohesh, kur ti bëhesh shkak
që t'i turret mikut një rrezik im adh.
Po këto natyra kështu i ka bërë
dhe përpara kokës sime që shpëtoi,
këto s'vlejnë gjë.

KREONI

(duke iu drejtuar Antigonës)

Eh, ti! atje!
Ty të flas, të pyes: a do ta pohosh
se këto i bëre, apo i mohon?

ANTIGONA

Unë vet'i bëra; nukë e mohoj.

KREONI

(duke iu drejtuar rojtarit)

Ti që u-lirove nga akuz' e rëndë,
Mund të shkosh, të ikësh, ku të dëshërosh.
(rojtari largohet)

KREONI

(duke u kthyer nga Antigona)

Ti atje, më thuaj, pa e zgjatur shumë:
a e dinje çpalljen që ndalon të bësh
atë që ke bërë?

ANTIGONA

S'mund të mos e dinja; ishte çpallur sheshit.

KREONI

E pastaj guxove urdhrin tim ta shkelësh?

ANTIGONA

Këto urdhëresa nuk i dha Zeusi;
edhe Drejtësija që banon te Hadi
nuk ka vënë ligje si këto të tuat;
as ndër mënd s'e shkonja se m'ato që çpalle,
ti, njeri i vdekshëm, do guxonje sheshit
të shkelësh të drejtat, të drejtat e hyjve.
Të shkruara s'janë — është e vërtetë, —
po në gjithë botën s'ka asnjë fuqi
që të mund t'i tundë, t'i rrëzojë, t'i prishë
këto s'janë gjëra që u çfaqnë dje,
as do jenë vetëm për sot e për nesër;
forca e atyre do ngelë për jetë
dhe nga kanë ardhur, nuk e di askush.
Këto pra të drejta s'ka njeri në botë
që të më shtrëngoje t'i marr nëpër këmbë
dhe pastaj nga hyjtë të dënohem keq.
Dinja që më parë, pa e çpallur ti,
se më priste vdekja; po një vdekj'e tillë,
vdekje para kohe, do jetë për mua
një e mir'e madhe, shpëtim i vërtetë.
Se për një si unë që jetoj me vuajtje
vdekja si nuk qënka një shpëtim i sigurt?
Unë asnjë dhembje s' ndjej për këtë fat
dhembje do të kisha po të mos varrosnja
tim vëlla, të cilin bash ajo e lindi
që më lind'e mua. Ja kjo do m'helmonte;
e sa për të tjerat, nuk më prekin fare,
s'dua t'ja dij,
në pra do më marrësh për ndonjë të marrë,
e marrë i dukem vetëm një të marri

KORI

Duket vajz'e egër, prej ati të egër,
s'ditka të përulet para çdo rreziku.

Kreoni (korit)

Po ti e di mirë se një shpirt krenar
bje dhe shpejt rrëzohet; dhe m'i forti hekur
sikundr'e ke parë, kur prej zjarrit digjet,
çahet edhe thyhet. A s'ke vënë re
se dhe kuajt'e egër me një fre të vogël
mbahen edhe zbuten? Një njeri që është
rob i ndonjë tjetri kurrë të mos mburret.
Kjo edhe ahere mua më përbuzte,
kur i shkelte urdhërat që i kisha dhënë,
e tashti po tallet me këtë që bëri.
Burrë pra s'jam unë, burrë qënka kjo,
në bëftë pas qejfit dhe pa u dënuar,
Kjo edhe e motra — qofshin time mbesa,
qofshin gjak m'i afërt nga ata të gjithë
që i ka në mbrojtje Zeusi vatrë-ruajtës —
s'kanë si shpëtojnë nga dënim i rëndë:
sepse dhe e motra ësht bashkëfajtore,
mbasi pati gisht në këtë varrim.
Thirrmani të vijë,
se tani e pashë brenda në pallat,
ku bënte lëvizje si ndonjë e çmendur.
Shpirti i njeriut që ngreh pllane fshehtas,
shpesh në punë'e sipër zihet, tradhëtohet
e kështu zbulohet faji që po bën
I urrej pa masë gjith'ata që bëjnë
punë të këqija dhe pastaj mundohen
të i zbukurojnë dhe t'i paraqitin
si të mira fare.

ANTIGONA

Ç'kërkon më të madhe, se sa vdekjen time?

KREONI

Tjetër nukë dua; në e kam këtë,
i kam që të gjitha.

ANTIGONA

Pse pra po e zgjat? Se sikundër mua
s'më pëlqejnë fjalët që nxjerr ti nga goja,

— e mos më pëlqefshin asnjëherë'o zot: —
edhe ty të miat të mërzitin shumë.
Ç'gjë do të më sillte lavdë më të madhe,
se sa do më sjellë puna që kam bërë,
që varrosa vetë vëllan tim të dashur?
Këtë e pëlqejnë dhe këta këtu,
bile do ta thoshnin vet' ata me gojë,
po të mund të flisnin si njerës të lirë.
Se përveç të tjerash që gëzon tirani,
ka edhe lirinë të flas' e të bëjë
ç'do që dëshëron.

KREONI

Nga ata që rrojnë në këtë Kadme
vetëm ti e ke këtë lloj mëndimi.

ANTIGONA

Dhe këta mendohen tashti mu si unë,
po ti u mbyll gojën e s'i le të flasin.

KREONI

Si s'ke pikë turpi
që mendohesh ndryshe dhe jo si këta?

ANTIGONA

Nukë është turp
të nderoj atë q'jemi të një barku.

KREONI

Si? s'e ke vëlla
dhe atë që vrau ky në luft' e sipër?

ANTIGONA

Dhe atë e kam prej një nën'e ati

KREONI

E pra nuk të duket q'e lëndon këtë,
kur nderon atë?

ANTIGONA

Ay që ka vdekur nuk mendon si ty.

KREONI

Si s'qënka kështu,
kur ti i bën nderë njësoj me atë
q'është tradhëtor?

ANTIGONA

Dhe ay i vrari është im vëlla;
nuk ka qënë rob.

KREONI

Mirpo njëri erdhi që të prish' atdheun,
kurse ay tjetri ra duke e mbrojtur.

ANTIGONA

Porse ligj'i Hadit është një për të gjithë.

KREONI

Njerëzit e mirë s'duhet t'jenë një
me ata të liqtë.

ANTIGONA

Po kush mund të dijë, në këto mendime
aprovohen edhe nga ata të Hadit?

KREONI

Kurrë një anmik edhe si të vdesë,
nuk mund ta bëj mik.

ANTIGONA

S'linda për urrejtje,
po për dashuri.

KREONI

Në duhet të duash, kur të zbreç te Hadi,
duaj të atyshmit; gjersa unë rroj,
grua s'do sundojë.

KORI

Ja po shoh Ismenën në port' e pallatit;
qan, derdh lot si breshër për motrën e shtrenjtë.
Një re hidhërimesh syt'i a mbulon.
lotët që i bien çurk së mjerës vajzë,
i shëmtojnë fytyrën, faqet bukuroshe

Skenë e tretë

(Kori — Antigona — Kreoni — Rojtari — Ismena)

KREONI

(duke iu drejtuar Ismenës)

Moj ti, që më thithnje fshehurazi gjakun,
strukur si nepërkë brenda në shtëpi!
Si nuk e kuptonja se dy veta mbanja,
dy armiq të fronit, dy armiq të mij?
Haj tashti më thuaj: në këtë varrim
pate gisht dhe ti, apo do mohosh
e me be do thuash se s'di gjë prej gjëje?

ISMENA

Në më jep kjo lejë, thom se edhe unë
asaj i ndihmova në këtë varrim;
e pra edhe unë jam bashkëfajtore.

ANTIGONA

Këtë drejtësia nuk do ta lejojë;
se as ti s'ke dashur as unë s'të mora
bashkëpunëtore.

ISMENA

Unë turp s'e quaj, kur ti ke mjerime,
të lundrojmë bashkë në det plot rreziqe.

ANTIGONA

Hadi m'ata poshtë dinë kush e bëri
punën e varrimit; unë nuk e dua,
nuk e dua mikun që vetëm me fjalë
tregon dashuri.

ISMENA

Mos, të lutem motër, mos më ler pa nder;
më lejo të vdesim që të dyja bashkë
e kështu dhe unë të nderoj vëllanë.

ANTIGONA

Një gjë që s'ke prekur, si qënka e jote?
S'ësht' aspak nevojë të vdesësh dhe ti;
mjafton vdekja ime.

ISMENA

Jeta më për mua ç'shije do të ketë,
po qe se do mbetem, do jetoj pa ty?

ANTIGONA

Pyet-e Kreonin; e ke kujdestar

ISMENA

Pse më ndez me fjalë nga të cilat ti
s'ke ndonjë fitim?

ANTIGONA

Vërtet qesh me ty, porse me sa helm!

ISMENA

Thuaj: a do mund të të jap një ndihmë,
qoft' edhe tashti?

ANTIGONA

Shpëto jetën tënde; nuk të kam zili.

ISMENA

Oh e mjera unë! pse të mos e kem
fatin tënd dhe unë?

ANTIGONA

Ti ke zgjedhur jetën, kurse unë vdekjen.

ISMENA

Po unë të thashë ç'kisha për të thënë,

ANTIGONA

Ca të quajnë ty, ca mua të urtë.

ISMENA

Sidoqoftë fajin të dyja e kemi.

ANTIGONA

Mos u bëj merak; se ti je e gjallë,
ndërsa shpirti im ka vdekur prej kohe;
po dobi kjo vdekje të vdekurv'u sjell.

KREONI

Nga këto dy vajza njera tani çmëndet;
kurse ajo tjera, qëkur është lindur

ISMENA

Nër mjerimet, mbret, mëndja nuk mbetet
ashtu siç ka mbirë, porse ikën, zhduket.

KREONI

Pa dyshim menç dolle, mbasi me të liqtë
ke bërë dhe ti punëra të liga.

ISMENA

Si mund të jetoj, pa patur këtë

KREONI

A! Këtë?
Mos e zër në gojë, zëre sikur s'ësht.

ISMENA

Si? Mendon të vrasësh nusen e tyt' biri?

KREONI

Ka të tjerë braza që mund të lërohen,

ISMENA

Po s'mund të ujdisin si këta të dy.

KREONI

Unë gra të liga kurrë s'marr për djemtë.

ISMENA

Emon fort i dashur! Sa të fyen yt atë!

KREONI

Shumë më mërzit ti dhe kjo martesë.

KORI

Vërtet ke vendosur t'ia rrëmbesh t'yt biri?

KREONI

Po këtë martesë Hadi do ta prish.

KORI

U vendos, si duket, vdekja e kësaj.

KREONI

Ashtu thom dhe unë! porse s'duhet zgjatur;
shpjerini, shërbyes, brenda në pallat.
Lidhini, të lira mos i lini fare;
se edhe guximtarët mendojnë të ikin,
kur e shohin vdekjen fare pranë tyre.

(Të dy motrat i shpjenë brënda në pallat; Kreoni qëndron)

Skenë e katërtë

(Kori — Kreoni)

KORI

Strofë I.

Lum ata që e kalojnë
jetën pa një hidhërim;,
se kur dor'e perëndive
tund, trondit ndonjë shtëpi,
një pas një fatkeqësirat
e mbulojnë bres pas brezi,
mu si val' e shkumbëzuar
në një det të egërsuar;
kur një er'e marr'e Trakës
u bie valëve, i hedh
gjer në errësirën poshtë,
poshtë thellë nënë det,
ngrehin nga abyssa thellë
zhur të zi e krejt si sterë
dhe gjëmojnë anëdetjet,
ku pëlcasin me tërbim

Antristrofë I.

Ja kështu, siç shoh, edhe
në shtëpi të Lavdakidve
fatkeqësirave të vjetra
po u shtohen krejt të reja;
brezi brezit s'ia heq,
po një hyj u bie, si duket,
dhe mbarim e liga s'ka.
Edhe një shkëndi që zuri
të ndriçojë ndër filizat,
ndër pasardhësit e fundit
të familjes së Edipit,
po e shuan drap'i Hadit,
çmënduria dhe tërbimi.

Strofë II.

Kush? o Zeus, guxon të mburret
se do mundë forcën tënde?
Forca që nuk e pengojnë
gjumi i tërëfuqishëm,
as dhe muajt që po ecin
dhe kalojnë pa u-lodhur?
Ti gjithmonë pa-u mplakur,
mbretëron për gjithë jetën
mbi Olimpin e shkëlqyer.
Në të shkuarën, të tashmen.
ashtu edhe në të ardhmen
ja ky ligj do bretërojë:
Asnjeri s'e ngrys dot jetën
pa provuar, pa pësuar
të këqia dhe rreziqe.

Antristrofë II.

Sa shpresa këmbëlehtë
që nuk le vënd pa shkuar,
për shumë ësht e mirë
kurse disa të tjerë
i rren me ëndërime
dhe ëndje krejt të kota.
Në çastin kur njeriu
as di, as pret gjësend,
afrohet, e pushton
dhe ky nuk e kupton
përveç se kur e shkel
me këmbët e tij zjarrin.
Se fjalë fort të urtë,
të urt, e plot kuptim
ka thënë një i ditur:
e liga nga ndonj'herë
i duket shum'e mirë
atij që perëndia
i merr më parë mëndjen,
kur do ta çkatërrojë;
ca çaste vetëm rron
pa vuajte, pa mynxyra.

(duke iu drejtuar Kreonit)

Po e shoh Emonin
djalin tënd të ri;
mos e pikëlloi
fat'i Antigonës?
Mos ësht dëshpëruar
pse s'e merr për grua?

KREONI

Ja tani këtë
ne do ta mësojmë edhe ca më mirë
se falltarët vetë.

AKT III

Skenë e parë

(Kreoni—Emoni—Kori)

KREONI

O bir! mos ke ardhur që të çfrysh mi mua,
mua q'jam yt atë, se vendosa kundër
vajzës me të cilën ke qen i fejuar?
Apo në çdo ras ti e do t'ët atë?

EMONI

Jam yt bir, o atë, dhe ti më drejton
me ato mendime q'janë fort të urta
dhe të cilat unë do t'i ndjek gjithmonë;
s'ka asnjë martesë që ta preferoj
nga këshillat tua, kur më prin si duhet.

KREONI

Bir, këto mendime gjithënjë t'i kesh
dhe gjithmonë t'ecësh si të thot' yt atë.
Prandaj çdo rob lyp
të bëjë fëmijë t'urtë dhe të bindur,
që t'i ketë ndihmës në shtëpi të tij,
kundër çdo njeriu që e ka armik
edhe miqt' e tija t'ia nderojn' ashtu
siç i ka nderuar edhe vet' i ati,
Po për njësoj njerës q'janë prindër djemsh
krejt të padobishmë, çmund të thuash tjatër,
veç se ata vetë vetes keq i bënë,
dhembje, kokëçarje vetes i shkaktuan

dhe e bëjn' armikun të qesh, të gëzohet?
Mos e humb, bir, mëndjen nga disa dëfrime
që mund të të japë, të të falë gruaja.
Sepse dij-e mirë, q'ato përqafime
q'jep një grua' e keqe, janë fort të ftohta.
Vërtet, ç'plagë tjetër mund t'jetë m'e madhe
se sa kur të liqtë i ke miq të dashur?
Epra jepi duart një të tillë femre,
që na është sjellë si ndonjë armik
dhe lere të shkojë posht' atje te Hadi
që të gjej' atje ndonjë burrë tjetër;
se me që kjo vajzë nga gjithë banorët
vetëm kjo guxoi urdhrin tim ta shkelë
unë para botës s'dal dot gënjeshtar,
s'e marr prapa fjalën', do ta vras pa tjetër.
Pastaj le të veje edhe le t'ankohet
pranë hyjit Zeus, mprojtësit t'atyre
q'janë midis tyre farë fis e gjak.
Dhe kur njerëzia q'i kam fis e gjak
nukë jan të bindur, po i shkelin urdhrat,
si do sillen vallë ata me të cilët
nuk më lidh asgjë?
Një që sillet mirë mbrënda në shtëpi,
ky do sillet mirë dhe me qytetarët.
Po për një që do urdhërat t'i shkelë
që guxon me forcë ligjet të prishë
që ka sy e faqe t'urdhëroj 'ata
që në dor' i kanë frenat e pushtetit,
për njeri të tillë nga goj' ime kurrë
nukë do të dalë asnjë fjal' e mirë
Po atij njeriu q'i u dha në dorë
pushtet' i qytetit, duhet që t'i binden
gjithë qytetarët edhe të pëlqejnë
çdo punë që bën
qoftë kjo e madhe ose dhe e vogël,
qoftë e padrejtë, ose pun' e drejtë.
Si pas mëndjes sime, një njeri i tillë
jo vetëm do dojë të sundojë ay
mi të tjerët mirë, po do doj' e vetë
të sundohet mirë; ky kur shkon në luftë,
vëndin që ka zënë, nukë e lëshon,
po si shok i besës e me trimëri
gjer në fund të luftës këtë vënd e mban

Një e keq' e madhe është anarkia:
kjo edhe qytete çkatërron, rrënon,
kjo shtëpi të tëra prish dhe i përmbys,
kjo edhe në luftë bëhet shkakëtare
që të thyhen shokët, t'ikin e të prapsen;
kurse disiplina më të shumt' e herës
ruan dhe shpëton jetën e atyre
që s'e lënë vëndin.
Ja ç'nevoj' e madhe të i mbajmë mirë
rregullat që duhen për një qeverim;
kurrë të mos ulim kryet para grave,
as të mos pranojmë të na mundin gratë;
në rast se ndonj'herë e kërkon nevoja,
është shum më mirë, që të bjesh prej burrash
se sa të të thonë, se prej grash u munde.

KORI

Në se mua trutë nuk më kanë rrjedhur,
si nga pleqërija, si edhe nga koha,
ti, o mbret, më dukesh se me mënd ke folur.

EMONI

Hyjtë, o im atë, njerësve u dhanë
mëndjen q'ësht m'e vyer se çdo gjë në botë.
Unë nukë mundem, as dhe nukë di
që të thom se fjalët e babait tim
nuk janë të drejta; mirë po e drejta
si nuk mund të gjindet edhe tek një tjetër?
Unë, si yt bir, e kam për detyrë
të vëzhgoj, të sillem edhe të përgjoj
ç'thonë kundër teje njerzit e qytetit,
ç'farë bëjnë vallë, ç'far 'ankimesh kanë;
sepse, o im atë,
syri yt tmeronjës nuk e le të thonë
fjalë të këtilla që ty s'ti ka kënda.
Lehtë ësht për mua të dëgjoj në t'errët
si për këtë vajzë qan qytet 'i gjithë;
asnjë faj kësajë nukë i ngarkojnë,
po nga gjithë gratë, thonë, vetëm kjo
do të gjejë vdekje të shëmtuar fort,
vetëm se ka bërë punë të lavdishme,
mbasi të vëllanë që u vra në luftë

nuk e la të mbetet krejt i pa varosur,
që ta hanë qenjtë, qenjtë edhe shpendët,
Pra një vajz e tillë — thonë qytetarët —
si nuk meriton një nderim të madh?
Ja pra ç'pëshpëritet në qytet për vajzën.
Atë, s'ka për mua pronë më të vyer,
se kur shoh se ti po jeton i lumtur
edhe i mbuluar me lavdi e ndere.
Ç'gëzim më i math është për fëmijët
se sa kur do shohin atin të jetojë
plot me lavdërime? Ashtu dhe një atë
kur mund të kënaqet shumë e më shumë,
se sa kur fëmijët i ka fort të mbarë?
Ti pra mos ngul këmbë tepër në mendimet
që ke çfaqur rishtas, as edhe mos thuaj
se e drejta është gjithmonë me ty.
Sepse ata njerës që besojnë se
vetëm ata flasin e mendojnë drejt,
ose ata vetëm kanë shpirt dhe gjuhë,
këta po t'i çveshësh dhe të i zbulosh,
do të shoç aherë q'janë krejt të zbrazur.
S'është turp njeriu, qoftë ky i ditur,
të mësojë shumë dhe të heqë dorë
nga kokfortësia. Hidh në sy në shelgjet
q'janë anës lumit: ata q'i përulen
rrymës së rrëmbyer, nuk pësojnë gjë
po këto dhe degët i shpëtojnë krejt;
po ato që duan të i venë kundër,
çkulen me një herë dhe me gjithë rrënjë.
Edhe kapedani që s'dëgjon të ulë
pëlhurat e anies, po lundron kokfortë
në det kundër erës, e përmbys anien,
e hedh n'ujrat thellë, ku ka për të mbetur
lodër për tallazet.
Lere pra më njanë zemërimin tënd
edhe me të shpejtë ta ndryshosh mendimin;
Në unë i riu mund të çfaq mendim,
thom se për njerinë është gjë e madhe
që të jet' i lindur plot me dituri;
po në qoftë ndryshe, se kjo ësht' e rallë,
është shumë mirë të marrë mësime
nga ata që flasin mirë dhe si duhet.

KORI *(Mbretit)*

Në foli mirë, dëgjoe mbret;
Dhe ti këtë; se kini folur
mirë të dy.

KREONI

Si? Në këtë moshë mua një i ri
të m'japë mësime se si të mendohem?

EMONI

Thashë të mos bësh gjëra të pa drejta;
jam i ri nga mosha, po ti mos shih vjetët,
shih vetëm mendimet.

KREONI

Është pun' e mirë të nderosh rebelat?

EMONI

Për të liqtë kurrë s'do kërkoj mëshirë.

KREONI

Një sëmundj' e tillë a nuk i ka rënë
dhe kësaj vajze?

EMONI

Populli i Tebës nukë thot' ashtu.

KREONI

Si? Qyteti mua do të më mësojë
se si të sundoj?

EMONI

Ja tashti s'ke folur si një djal' i ri?

KREONI

Këtu kush jep urdhëra? Un'a ndonjë tjetër?

EMONI

Mos qyteti është pron' e një njeriu?

KREONI

A nuk është shteti i atij njeriu
që i ka në dorë frenat e pushtetit?

EMONI

Bukur do sundonjë në një shkretëtirë!

KREONI

Ky, si duket, është aleat i gruas,

EMONI

Në je grua ti; se për ty kujdesem.

KREONI

Or shumë i dobë, i bën gjyq t'yt eti?

EMONI

Se shoh që gabon dhe nuk je i drejtë.

KREONI

Gaboj pse nderoj parimet e mia?

EMONI

Jo, sepse i shkel të drejtat e hyjve.

KREONI

Shpirt i mallëkuar! Ti skllav i një femre!

EMONI

S'do më shohësh kurrë skllav të ndonjë trupi!

KREONI

Ti çdo që ke folur, për atë ke folur.

EMONI

Dhe për ty, për mua dhe për perënditë.

KREONI

Kjo sa është gjallë, ti s'e merr për grua.

EMONI

Vërtet do të vdesë, porse do të marrë
dhe një tjetër pas.

KREONI

Guxon, i pa-turpshëm, të më frikësosh?

EMONI

Frikësim e quan t'u japësh përgjigje
fjalëve pa mënd?

KREONI

Ti, pa tru në kokë, duhet të vajtosh
që të vish ndër mënd.

EMONI

Sikur të mos ishe ti ati i im
do të thojsha që s'arësyeton.

KREONI

Vërtet? Për Olimpin, duhet pra ta dish,
se do të dënohesh për gjith ato fyerje.
(duke iu drejtuar shërbëtorit)
Sille vajzën e urrejtur,
që të vdesë me njëherë
bash në sy të këtij dhëndëri.

EMONI

Si? Në syt e mi? JO, mos e shpreso;
ajo pranë meje nukë do të vdesë,

as ti s'do më shohësh më përpara teje;
ti tërbo me miqtë që po të durojnë

(del Emoni)

Skenë e dytë

(Kori—Kreoni)

KORI

O mbret, iku djali nga inat' i nxehur;
kur i riu ndodhet shum' i turbulluar,
merr disa vendime q'janë fort të rënda.

KREONI

Vaftë ku të dojë; bëftë pllane mbinjerëzore.
Sidoqoftë vajzat s'ka për ti shëtuar.

KORI

Vërtet që të dyja mendon të i vrasësh?

KREONI

Jo edhe atë që s'ka bërë gjë;
ke shumë të drejtë.

KORI

Po me çfar lloj vdekje vendose ta vrasësh?

KREONI

Kam për ta dërguar në një vend të shkretë,
do ta mbull të gjallë në shpellë shkëmbi,
ku do të i le një sasi ushqimi
aq sa ësht' e mjaftë të lajë mëkatin,[1])
me qëllim që njolla e këtij mëkati

---

[1]) Sipas besimeve të grekëve të vjetër, mëkati evitohej, po të vihej një sasi e vogël ushqimi pranë atyre që mbylleshin të gjallë në vorr, si këtu Antigona.

të mos prek qytetin; le ti lutet Hadit,
të vetëmit hyj që nderon ajo:
le ti lutet pra ta shpëtojë nga vdekja
edhe ka të ngjarë t'ja dëgjojë lutjet;
po në rast se jo, sigurisht do bindet
se e kotë qënka të nderosh të vdekurit.

Skenë e tretë

KORI

Strofë

Dashuri, që gjithëmonë
nukë thyhesh ndër betejat!
Dashuri, q'hyn në pallatet,
ti që natën i ngre çerdhet,
nëpër vajzat faqe njomë,
ti që ujrat i përçan
dhe kalon tej oqeanit;
ti që shkon në mal' e stane,
zbret në fushë me kasolla,
ti që me fuqinë tënde
s'le pa prekur, pa goditur
të pavdekëshmit perëndi,
si dhe njerëzit ditshkurtër,
dhe ay që ke pushtuar,
bën tamam si një i çmëndur.

Antristrofë

Ti dhe njerësve të drejtë
mëndjet u a turbullon
dhe u kall padrejtësira
q'i dëmtojnë ata vetë.
Ti je ajo që shkaktove
dhe këtë të shkretë grindje
në mes njerëzish që janë
prej një fis' e prej një gjaku.
Dashuria që shkëlqen
për mbi syt' e nuses bukur,
ligjet e mëdha i mund
dhe s'i quan për asgjë
se këto jan lodr' e tallje
t'Afrëditës së pathyer,

Po tashti dhe unë vetë
kur i shoh këto të gjitha,
dal nga urdhërat e mbretit
dhe më lotet nuk i mbaj;
sepse shoh që Antigona
po drejtohet e po niset
për në dhomn' e nusërisë
q'është dhomë për të gjithë.
(e sjellin Antigonën)

Skenë e katërtë

(Antigona—Kori)

ANTIGONA

Strofë I.

Shih-më-ni, o qytetarë,
ju t'atdheut stërgjyshor!
Her' e fundit është kjo
që po shkoj në këtë udhë;
ja sot për të fundit herë
po e shoh dritën e djellit,
që s'kam për ta parë më;
sepse Hadi që çel dyert
për të gjithë njerëzinë,
po më shpje mua të gjallë
për në buzë t'Akerondit,
mua që martesë s'pashë,
që s'dëgjova të buçasin
këngë dasme rrotull meje,
që do marr për burrë oh!
Akerondin, un' e shkreta.

KORI

Ti në këtë shpellë,
ku të gjithë nisen
njerëzit e vdekur,
po zbret e nderuar,
zbret e lavdëruar;
s'të pushtoi lëngata,
s'të ka prerë shpata;
vetëm ti nga gjithë

njerëzit e vdekshëm
shkon te Hadi drejt,
shkon e gjall' e lirë.

ANTIGONA

Antristrofë I.

Kam dëgjuar për të bijën
e Tantalit nga Frigjia,
se një fund të tmershëm pati
përmbi majën e Sipilit;
rreth kësajë mbiu shkëmbi
e mështolli rreth' e rrotull
mu si dredhkël që rrethon
dhe shtrëngon fort e më fort,
dhe tashti, si thonë bota,
shira, breshër po e tretin
dhe këtu dëbora s'ikën,
po qëndron përgjithëmonë;
faqet krejt i rrinë lagur,
nga që lotet s'i shterojnë;
perëndia edhe mua
më dha fat si të kësajë.[1])

KORI

Po ajo ish perëndeshë
dhe prej perëndish e lindur,
kurse ne të vdekshëm jemi,
dhe të lindur prej të vdekshmish.
Po prap është gjë e madhe
që të thuhet për njeri,
se ky fundin e ka patur
si atë të perëndive.

ANTIGONA

Strofë II.

Un' e mjerë!
Po më tallin!
Pse për hyjtë shtërgjyshorë,
nukë prisni të largohem,

[1]) Fjala është për Nioben (shih shënimet në fund të librit)

po më shani ashtu hapur?
O qytet, qytet i im!
dhe ju burra pasanikë
të atdheut tim të dashur!
Ju o çezma të Dirkesë,
dhe ti pyll i veneruar,
pyll i Tebës famë-madhe
për karrocat fort të mira!
Po ju ftoj si dëshmimtarë
të shikoni, të dëshmoni,

se me çligje do të çdukem.
Miqt' e mij s'po më përcjellin,
s'qajnë, s'derdhin lot për mua,
që po shkoj, e mjera unë,
te një gropë krejt të errët,
që do jetë varri im.
Un' e mjera! Nukë jam
as e gjallë me të gjallët
as e vdekur me të vdekurit.

KORI

Ti, moj bijë ke treguar
një guxim të pa-kufishëm
dhe prandaj përpoqe kryet
mu në fron të drejtësisë,
q'e ka ngritur atje lartë;
duket se ti lan ndonjë
nga mëkatet e t'yteti.

ANTIGONA

Antristrofë II.

Më kujtove hidhërime
helme, dhembje të mëdha,
më kujton fatkeqësinë,
që pësoi im at' i shkretë,
si dhe gjith' ato të zezat
që pësuan e që hoqnë
Lavdakidët e dëgjuar.
O martes' e mallëkuar
e së mjerës nënës sime

q'u martua me të birin[1])
dhe më lindi mua, korbën!
Për atje tashti po nisem
që të rroj me ata bashkë
korba un', e zeza unë,
që kam mbetur pa martuar.
O vëlla, vëlla i dashur,
në martesë i pafat,
vdiqe, po më vrave mua,
ndonëse gjallë edhe jam

KORI

Është gjë e shenjtë sigurisht
të nderojm' ata që vdesin.
Po dhe urdhërat e pushtetit,
në çdo duar që të ndodhet,
nukë ësht' aspak me vënd
t'i përçmojmë, t'i përbuzim.
Ti pësove nga inati
dhe nga kokëfortësia.

ANTIGONA

O e mjera unë,
për të fundit herë
po kaloj këtej,
pa miq, pa vajtime
dhe e pa-martuar!
Nuk do kem mëllejë

Oh! e zeza unë,
të të shoh, o dritë,
e llampadhës shenjtë
që çkëlqen në qiell!
Asnjë mik që patmë
lotë nukë derdh,
asnjë s'psherëtit
për të shkretin fat
që më ra në kokë.

---

[1]) Edipi pa ditur mori për grua tëmën Jokasten; nga kjo martesë lindi Antigona

Skenë e pestë

(Kori—Antigona—Kreoni)

(Hyn Kreoni befas)

KREONI

A e dini se të qarat
e vajtimet para vdekjes
s'kanë të mbaruar kurrë,
kur besojnë se këto
një dobi do mund të sjellin?
Shpjer-eni këtë më shpejt
gjer në varrin e mbuluar
dhe aty e mbyllni mirë
ashtu siç kam urdhëruar;
ler'eni aty të dergjet
krejt e vetëm dhe e shkretë,
le të vdes' aty në dashtë
ose le të rrijë gjallë
mbyllur dhe mbuluar brenda
në një strehë të këtillë.
Ne të paktën kësaj vajze
nuk i kemi asnjë faj;
si do qoftë, s'mund të rrojë
këtu sipër me ne bashkë.

ANTIGONA

O varr, o shtrat nusërije,
o shtëpi e nënëdheshme,
që gjithmonë do më ruash!
Sot po nisem, sot po shkoj
atje poshtë te të mijtë,
q'i ka pritur Persefona
— oh sa shumë kanë qenë—!
n'ato vënde ku pushojnë
gjith' ata që mbyllnë sytë.
Pas këtyre jam e fundit
dhe më shumë e mjeruar,
që po vete pran' atyre
pa arritur ora ime,

që më ka caktuar fati.
Po kam shpresa të mëdha
se kur do të shkoj atje,
ati im do të më dojë
edhe ti, moj nën' e dashur,
bashkë me vëllakon tim.
Se kur ju rrëmbeu vdekja,
unë ja me këto duar
ju kam larë, ju stolisa
dhe libasione bëra
për mi varret ku pushoni.
Dhe tani, o Polinikë,
ja se si shpërblehem unë
që nderova trupin tënd.
(se vërtet të kam nderuar,
siç po thon' ata me mënd).
Sikur t'isha bërë nënë
dhe të isha me fëmijë,
ose burri im të vdiste
dhe të treteshe në dhe,
barrë si këtë që mora
kurrë s'do ta kisha marrë
kundër mëndjes, e dëshirës
së qytetasve të mij.
Po pse vallë flas kështu?
Në do vdiste burri im,
mund të merrnja ndonjë tjetër;
në do të rrembente vdekja
djalin ose vajzën time,
do ta vinja prap në vënd
duke marrë burrë tjetër.
Pa tani që nën' e atë
kanë zbritur në skëterrë,
s'ka se si të bëhem motër,
vëlla tjetër s'mund të kem.
Ja përse, vëlla, vendosa
ty veçan të të nderoj.
Po Kreon-i, o vëlla,
më ka quajtur guximtare,
guximtare dhe fajtore,
ja ku po më zë me duart,
zvarë, zvarë po më heq
mua që martesë s'pashë,

që fëmijë nukë bëra;
po kështu e mjera unë
pa miq fare, e shkretuar,
zbres e gjallë n'ato gropa
ku të vdekurit banojnë.
Çfar të drejte hyjnore
kam përbuzur, kam shkelmuar?
Është kot, e shkreta unë,
s'ka dobi që të ngre sytë
t'i shtje lart' atje në qjell!
Kë të marr e kë të thërres
si përkrahës e si shok?
Shkoj vërtet si e pa fe
ndonëse pas fesë bëra.
Po të jetë se këto[1])
i pëlqejnë perënditë,
thom se mirë e pësova
sepse në mëkat kam rënë.
Po në qoftë se mëkati
është vetëm i këtyre,
mos pësofshin më të zeza
se ato që më shkaktuan
ata pa asnjë të drejtë!

KORI

Gjithmonë në shpirt të saj
sillet, rreh e njëjës dallgë,

KREONI

Prandaj do të qajnë
ata që e shpjenë
aqë me ngadalë.

KORI

Medet! Këto fjalë
po e sjellin vdekjen
më afër akoma.

---

[1]) D. m. th. dënimin tim.

KREONI

Ti mos shko me këtë
mëndje se vendimi që kam marrë,
gjoja nukë do zbatohet.

ANTIGONA

O tokë e Tebës,
qytet atëror,
edhe ju, o hyj,
hyj të fisit tim!
Nuk ka më vonesë!
Ja, ku po më heqin!
Ju pari e Tebës,
shtini syt' e shihni
shih-mëni të mjerën!
Unë që kam mbetur
një dhe fillka vetëm,
shihni ç'po pësoj,
vetëm pse kam bërë
detyrë të shenjtë

(del Antigona e hequn zvarë prej rojtarëve)

KORI

Strofë I.

Vuajti shumë dhe Danaja
mbasi dritën qjellore
e këmbeu me banesë
të ndërtuar krejt prej remi.
Edhe kjo u mbyll në varr
si në shtrat të nusërisë,
edhe kjo, moj bijë ime,
ish nga origjin' e lartër
dhe në bark fëmijë mbajti
nga Zeusi që i hodhi
farën mu si shi të artë.
Fati ka vërtet fuqi,
një fuqi të madhe shumë:
s'mund që të shpëtoj' asgjë:

as paraja, as dhe pushka,
as kështjellat e mëdha,
as anijet ngjyrë zeza
që i rreh tallaz' i detit.

Strofë II.

Edhe birin e Driantit
që sundonte në Hedonët,
me që ishte i rrëmbyer
edhe tallej, qërtonte,
Bakhus-i në pranga gurësh
e burgosi dhe e lidhi.
Ja kështu e çfreu ky
zemërimin me tërbim,
zëmërim që ësht' i tmershëm
dhe që nukë zbutet kurrë.
Më von' e kuptoi dhe vetë
se me marrëzin' e tij
kishte prekur perëndinë
m'atë gjuhë si gërshërë.[1])
Kur ish fest' e perëndisë
gratë Bakhante pengonte,
u a shuante llampadhet
edhe muzat i ngacmonte,
ato muza q'u pëlqen
fyelli me tinguj t'ëmbla.

Strofë II.

Pranë gurëve Qyane,
ku bashkohen të dy detet,
ndodhen buzët e Bosforit
edhe Salmedes' e Trakës
q'është tepër e rrezikshme
për ata që shkojn' andej.
Aty perëndia Ari
që ka tempull fare afër
pa fatkeqësin' e zezë
të dy djemve të Fineut,
se si gruaja e tij,

[1]) Mbi vuajtjet e Danaës dhe të birit të Driantit shih shënimet në fund të librit.

kriminele dhe e egër
u a nxori sytë djemve
jo me shtiza dhe me hekur,
po me duart tërë gjak
dhe me majën e gjëlpërës.

Antristrofë II.

Prej kësaj së keqes madhe
djemtë treteshin qanin
si për fatin e atyre
si dhe për atë të nënës,
sepse pati një martesë
që ka qënë krejt pa fat
dhe q'i lindi për të vuajtur.
Edhe kjo nga origjina
kishte qënë e dëgjuar,
mbasi fisi i saj ishte
nga familj' e Erekthivet.
Nëpër shpella larg u-rrit
dhe në male fort të larta,
atje ku i at' i saj
fryn e vërshëllen furishëm,
si një kalë këmbë-shpejtë
hidhet e kërcen mbi gurët
vajza, bijë perëndie,
që Verinë kishte atë;
po dhe mbi këtë, moj bij,
ranë fatet jetë gjata[1])

(Hyn Tiresia)

---

[1]) Gruaja e parë e Fineut, Kleopatra, origjinën e kishte nga Erektheidët, stënipërt e Erektheut, birit të Efestit.

AKT IV

Skenë e parë

(Tiresia—Kreoni—Kori)

TIRESIA

O pari e Tebës, arritmë të dy
dhe me syt e njerit shihnim që të dy;
se ay pa sy, pa një udhëheqës
nuk e gjen dot rrugën

KREONI

E xha Tiresia, ç'të reja na sjell?

TIRESIA

Kam për të t'i thënë; dëgjoe shortarin

KREONI

S'jam larguar kurrë nga këshillat tua.

TIRESIA

Ja pra pse qytetin ke sunduar mirë.

KREONI

Për këtë dëshmojnë gjith' ato të mira,
ato q'i kam bërë me këshillën tënde.

Oreitia, bija e Erekteut dhe gruaja e Boreut (perëndisë së veriut) ishte nëna e Kleopatrës. Kjo e fundit hidhej dhe kërcente nëpër shpellat e Trakës, banesës së t'et Boreut.

TIRESIA

Po tashti ki mëndjen, sepse ke arritur
mu në teh të thikës,

KREONI

Vallë çfarë ngjet?
Se, për besë dridhem, kur ti nis të flasësh.

TIRESIA

Pa dëgjo-ji shënjat e do të kuptosh.
Unë kisha ndenjur në fron tim të vjetër
dhe sipaz zakonit shihna rreth e rrotull
se si fluturojnë zoqt' e këtij vëndi.
Befas krejt ahere po dëgjoj ca zëra,
zëra fort të egra që lëshonin shpendët
mu si të tërbuar; edhe unë vetë
s'i kuptonja fare, po nga zhurm', e egër
që po bënin krahët e këtyre zogjve,
mora vesh q'ata me kthetrat u binin
njeri tjetrit fort dhe i copëtonin.
Unë i tmeruar shkova te altarët,
për t'i parë flitë q'ishin përmi zjarret,
zjarret që po digjinin nga të gjitha anët
pa lëshuar flagë.
Lëngu që po dilte nga mëshrat që trette
të nxehtit e zjarrit, mbi hirin kullonte!
Zjarri po lëshonte iskra, tym e avull,
tëmbëthet e flive kërcenin në erë
edhe mishi lagte dhjamin q'ish përsipër.
Mua këto shënja të këqia fort
m'i tregoi ky djalë q'e kam udhëheqës,
siç jam udhëheqës unë për të tjerët.
Gjith' ato të zeza i pëson qyteti,
mbret, nga koka jote. Se të gjith' altaret
bashkë edhe vatrat janë plot me copëra
mishi nga kufoma e fatziut djalë,
birit të Edipit, që i suall qenjtë
duke copëtuar trupin e atij.
E prandaj pra hyjtë më s'na i pranojnë
lutjet, sakrificat, flagën e atyre;
zogjtë s'po lëshojnë zëra të ugurta,

sepse gjak të trashë pinë nga kufoma
e atij të vrarit. Mblidh pra mënttë, bir;
çdo njeri gabohet, po njeri me mënd
si edhe i lumtur, është bash ay
që kur bën gabime a ndonjë të ligë,
s'rri me duart kryq, nuk rri pa lëvizur,
po shëkon të ndreqë fajet që ka bërë;
njerëzit përkundër që janë brutalë
me të drejtë quhen, njerës fort të liq.
Ti pra një njeriu që është kufomë
mos i bjer në qafë.
Trimëri e quan t'i bjesh dhe një herë
atij q'ësht' i vdekur, që s'ësht' më i gjallë?
Me qëse, o bir, të dua të mirën,
po të jap këshilla për të mirën tënde.
Cilit do i kënda të dëgjojë nga goja
e një oratori fjalë plot me shije,
po dhe me dobi.

KREONI

Plak! po shoh se ju
që të gjithë shtihni kundër një njeriu!
Ju me profetira mu si me shigjeta
suleni mi mua; po s'ësht' her' e parë
që më tradhëtojnë; edhe tjetër herë
keq më tradhëtuan njerëzit e mij,
ata q'i kam patur gjak e fisin t'im.
Bëni, ju, fitime aqë sa të doni,
sillni mall nga Sardes e nga Indi ar!
çdo gjë që të bëni,
s'ka varrim pët 'të.
Sikur dhe shqiponjat e Zeusit vetë
ta rrëmbenin trupin e ta ngrinin lart
për ta vënë para fronit të Atij,
prapë dhe kjo kurrë s'do të më tmeronte
as do më shtrëngonte që të jipnja leje
të varrosej trupi i atij të vrarit;
se di fortë mirë që asnjë njeri
nga ata që rrojnë për mi këtë dhe,
nuk e ka fuqinë që t'i fyejë hyjtë.
Shpesh, xha Tiresia, dhe njerës të çquar
bjen në gabime, shumë keq rrëzohen,

bëhen si kufomë e si lecka fare,
kur këta të shtyrë vetëm nga paraja
thonë vërtet fjalë plot me art' e shije,
po dhe plot me turp, për faqe të zezë

TIRESIA

Medet! Medet!
A ka vallë njerës që të dinë se...

KREONI

Ç'është, Tiresia, ç'është kjo që thua
për të gjithë njerëzit?

TIRESIA

...se për njerëzinë pronë më e vlefshme
është mënçuria?

KREONI

Aqë sa e keqe ësht dhe marrëzia

TIRESIA

Ja nga kjo sëmundje ti veçan po vuan.

KREONI

S'dëshëroj shortarit t'ia kthej të sharat.

TIRESIA

Po ja ku e bën,
sa po që më thua se jam gënjeshtar.

KREONI

Shortarët të gjithë lakmojnë paranë.

TIRESIA

Po edhe tiranët lakmojnë fitime
fare të pa drejta.

KREONI

A di se këto ia thua mbretit?

TIRESIA

E di fare mirë, se me fjalën time
shpëtove qytetin dhe sot mbretëron.

KREONI

Ti, mor Tiresia, je shortar i zoti
po padrejtësirat i përkrah, i mbron.

TIRESIA

Mbret! më detyron që të nxjerr në shesh
gjith' ato që mbanja fshehur mu në zëmër.

KREONI

Nxirri, more nxirri, vetëm mos më folë
për pun' interesi.

TIRESIA

Për njeri të tillë më ke njohur, mbret?

KREONI

Mblidhe mëndjen mirë se ti me këto
s'mund të më gënjesh.

TIRESIA

Mëso pra se dielli q'ecën me shpejti
nuk do bëjë edhe shumë rrotullime,
kur ti një fëmijë do të nxjerrësh nga gjiri
si shpërblim, si shpagë kundrejt sjelljes sate,
që tregove karshi vajzës së mjeruar;
krejt me të pa drejtë këtë e dërgove
n'atë botë posht dhe si për dënim
e mbylle të gjallë brenda mu në varr;
atë tjetrin prapë q'është nënë mbrojtje
të atyre hyjve posht atje te Hadi,

po e mban të vdekur, s'e le të varroset
as e të nderohet; po këtë të drejtë
nuk e ke as ti, as dhe hyjt' e qjellit.
Ti me forcë vetëm po e bën këto
e me kokën tënde. Prandaj edhe Nëmat
e hakmarrjes s'hyjve të Hadit e qjellit
ruajnë të të zenë në mëkat e sipër
dhe të të dënojnë simbas fajit tënd.
Thuaj dhe një herë që këto i thom
sepse jam i shitur. Po të thom se shpejt
nga pallat' i mbretit do dëgjohen vaje,
vaje, ulërime femrash edhe burrash.
Qytete të tërë ngrihen kundër nesh,
sepse egërsirat, qenjtë edhe shpendët,
në këto qytete suall copëra mishi,
copëra q'ja rrembyen trupit Polinikut,
ose nonjë shpendë mbase e ka shpënë
në shtëpit' e tyre erën e kufomës,
q'është për banorët tepër e mërzitur.
Me qënë se zemrën plot me vrer ma mbushe,
t'i thom këto fjalë dhe këto shigjeta
i hedh kundër teje ashtu si i hedh
shigjetar' i aftë. Sigurisht këto
nukë do të shkojnë n'erë dhe më kot:
flagën e këtyre ti ke për ta ndjerë.
E tani, or djalë, shpjer-më në shtëpi;
le ta lemë mbretin t'i nxjerrë inatet
mi të tjerë njerës q'janë më të rinj,
të mësojë t'i verë fre asaj goje,
që ma ka si shpatë, të mendohet mirë
e të bëhet pak njeri më i urtë.

(Del Tiresia)

Skenë e dytë

(Kori—Kreoni)

KORI

O mbret! iku plaku, po tha profetira
tepër të këqija. Ne në këtë moshë
që na u zbardhnë flokët, fort mirë e dimë
se shortari ynë në këtë qytet
gjer më sot s'ka thënë kurrë gjë të rremë.

KREONI

E kuptoj dhe unë, mëndja ment më lot;
se edhe të mprapsem është gjë e tmershme
dhe të kundërshtoj e me kundërshtimin
të i sjell mynxyra unë vehtes sime,
    është më e tmershme.

KORI

Kreon,
bir i Menikeut, të mendohesh mirë.

KREONI

Çduhet pra të bëj? Thuajmë; do bindem

KORI

Shko, liroe vajzën prej burgut nëndheshëm
dhe lejo varrimin e atij që vdiq.

KREONI

Kështu pra më thua? Më shtyn të përulem?

KORI

Sa më parë, mbret; me çape të shpejta
u bjenë fajtorëve dënimet e hyjve.

KREONI

Oh, mezi heq dorë nga vendimi im,
porse do ta bej, se lufta me fatin
    ësht e pa dobishme.

KORI

Punën ndonjë tjetri mos ia ngarko;
    vetë ti të shkosh.

KREONI

Ja tani po shkoj; ju, o shërbëtorë,
ata q'jini pranë, dhe ata të largmit,
shkoni me sopata n'atë breg atje.

Mbasi ndrova mëndje, unë që e lidha,
un' e do ta zgjidh, kam frikë se mos
ësht shumë më mirë jetë ta mbaroj,
duk' i ruajtur ligjet.
(Del Kreoni)

KORI

Strofë I.

O ti, q'adhurohesh
nën shumë emra,
ti stoli e bukur
e së bijës Kadmit,
ti djal i Zeusit,
që drejton rrufetë,
ti që Italinë
famëmadhe mbron.
Ti që mbretëron
në gji të Demetrës
brenda n'Eleusinë
që pret gjithë botën[1])
Bakho, ti që zgjodhe
për banesë Tebën,
qëndrën kryesore
ku Menadet rrinë
afër ujit rrjedhës
të lumit Izmenit
edhe përmbi tokën
ku u mbuall dhëmbët
e Draguas s'egër.[2])

Antristrofë I.

Ty po të shikon
tymi edhe flaga
që nga shkëmb' i lartër
edhe dy krenor,
atje ku buron
kroj' i Kastalisë
dhe ku vallëzojnë

[1]) I drejtohet Bakhut, birit të Semelës, bijës së Kadmit.
[2]) Tebanët mburreshin se origjinën e kishin nga dhëmbët e draguas s'egër q'e vrau Kadmi.

njëlloj si Bakhidet
nuset e Korikës.
Ty mali i Nisës
plot me gardhe urthësh
dhe rrëzë të blerta
plot me veshë rrushi
të përcjell me pompë
kur ti vjen në Tebë
që të na shikosh,
rrugët të përçash
duk' u shoqëruar
prej hymnesh hyjnorë
që po i këndojnë
për lavdinë tënde.

Strofë II.

Ti mbi çdo qytet
e nderon këtë
bashkë me të tëmë
që i ra rrufeja;[1])
dhe tani që ra
një lëngat' e fortë
në qytet të tërë,
duke kapërxyer
majat e Parnasit,
ose edhe grykën
që buçet në det.[2])

Antristrofë II.

O ti, që heq vallen
me hyjet çkëlqenjës
dhe drejton ti vetë
hymnet harmonike
që këndohen natën;
eja, mbret, te ne,
ti bir' i Zeusit,

---

[1]) Semela, siç thonë, vdiq nga friga e zhurmës së rrufesë kur iu afrua Zeusi.

[2]) Thotë për ngushticën e Euripit në ishullin Eubea.

bashkë me thyadet
dhe si të xhindosura
rreth' e rrotull teje
hidhen e kërcejnë
gjatë gjithë natës
për nder të Bakhusit,
kryetarit tyre.

AKT V

Skenë e parë

(Kori—Lajmëtari)

(Hyn lajmëtari)

LAJMËTARI

O ju që banoni rreth edhe përqark
shtëpisë së Kadmit e të Amfionit!
Jetën e njeriut, sido qoftë kjo,
unë, sa për vete, s'mund ta lavdëroj
po as nukë mundem e ta kritikoj.
Fati ësht' ay që rrënon, që ngre
gjithë njerëzinë: të mjerë, të lumtur.
S'mund të parashohë asnjë nga të vdekshmit,
ç'fat ka për ta gjetur në kohën e ardhme.
Ja këtij Kreonit, pas mendimit tim,
dhe, pardje i kishte zili gjithë bota;
sepse dhen' e Kadmit e shpëtoi ng' armiqtë,
frenat e pushtetit në dor' i ka marrë
dhe ushtron këtë si ndonjë monark.
Veç këtyre kishte dhe fëmij të mbarë
e kështu arriu kulmin e gëzimit.
Po këto të gjitha i humbet ky sot,
se, pas mëndjes sime, gjith' ata që s'ndjejnë
asnjë lloj gëzimi, s'janë më të gjallë,
po të vdekur janë dhe të pa mbuluar.
Mund të jesh i pasur aqë sa të duash,
jeto, po të duash, madhërisht si mbret:
në se pas këtyre nukë vjen gëzimi,
gjith' ato të mira nukë do t'i blinja
as me hije tymi.

KORI

Mos ke ardhur vallë të na lajmërosh
për ndonjë të keqe tjetër të monarkut?

LAJMËTARI

Vdiqnë; dhe të gjallët janë shkakëtarë.

KORI

Kush ka qënë vrasës? Kush u vra? Na thuaj.

LAJMËTARI

Emoni u vra, jo prej dore t'huaj.

KORI

Vet' e vrau vehten, apo dor' e t'et?

LAJMËTARI

Vet' e vrau vehten se ish zëmëruar
kundër atit tij për vrasjen e vajzës.

KORI

Ja, xha Tiresia, si të dolli fjala!

LAJMËTARI

Si do që u bënë, le t'i lem' ato;
tani duhet parë për të tjerat gjëra.

KORI

Ja tashi po shoh
Eurdiqn' e mjerë, gruan e Kreonit,
që del nga pallati; a del rastësisht,
apo mos dëgjoi ç'fat e gjeti djalin?

(Hyn Euridiqi)

Skenë e dytë

(Euridiqi—Lajmëtari—Kori)

EURIDIQI

Un' o qytetarët, fjalët i dëgjova,
kur po dilnja jashtë nga pallati im
edhe në faltoren e Palladës vinja,
për të i u falur kësaj perëndeshe.
Kur lëviznja llozin për të çelur derën,
në vesh pa pandehur m'erdhnë fjalët juaj,
që po pëshpëritnit për një fatkeqësi
që ka ngjarë brenda në shtëpinë time.
E tmeruar rashë sa e gjatë isha,
sikur të më kishte rënë ndonjë pikë;
mezi shërbëtorët më ngritnë në kambë.
Thomëni dhe nj'herë: ç'ishin këto fjalë?
Do të i dëgjoj; se fatkeqësirat
më bënë të fortë.

LAJMËTARI

Unë, zonj' e dashur, ja me këto sy
i kam parë ngjarjet; pra do të të thom
tërë të vërtetën e s'do fsheh asgjë.
Vërtet pse në krye të thom fjalë t'ëmbla
e më vonë puna të nxjerrë në shesh
gënjeshtrat e mia? Vetëm e vërteta
është dhe gjithmonë ka për të qëndruar.
Unë këmba këmbës ndoqa burrin tënd
gjer në fund të fushës, ku ish shtrirë edhe
trup' i Polinikut i ç'jerrë prej qenjve.
Këtu iu lutmë asaj perendeshe[1])
që rri anës rrugës si edhe Plutonit,
që të mos na mbajnë asnjë lloj mërije;
trupin e pastruam me ujë të pastër
dhe mi deg' e vumë q'ishin prerë rishtas;
dogjmë gjithë pjesët q'edhe kishin mbetur
edhe përmbi tokën e këtij trualli
kemi ngritur varrin musi piramide.

---

[1]) Është fjala për Hekaten, perendeshën mistike që rrinte nëpër rrugët.

Nisemi pastaj drejt për n'atë vend
q'u — bë nusërorja e vajzës te Hadi,
e gërmuar thellë brenda në një shkëmb,
e ndrequr me gurë brenda si një dhomë,
dhomë nusërije t'Antigonës mjerë.
Befas prej së largu një prej nesh dëgjoi
vaje dhe rënkime që dilnin prej varrit,
varrit të braktisur, varrit të shëmtuar.
Vjen me vrap tek ne dhe ia tha Kreonit
gjith' ato të qara që i kish dëgjuar.
Ky si erdh më afër varrit dhe dëgjoi
gjith' ato rënkime, „o i mjeri unë"
thirr' i libetitur, a mos jam shortar?
A mos vallë rruga që po shkoj tani

do jetë m'zezë nga të gjith ato
që shkova gjer sot? Se ky zë më duket
si i djalit tim.
Shpejt, ju shërbëtorë, shkoni drejt në varr
dhe e ngrini gurin që e mbyll këtë;
pastaj që nga vrima hyni n'atë brenda
dhe shikoni mirë në vërtet ky zë
është i Emonit, apo mua, korbin
më gënjenë hyjtë. „Si pas këtij urdhri
që dha mbreti ynë, mbreti i hutuar,
vamë gjer te vëndi dhe me plot kujdes
kemi kqyrur varrin q'ish banes' e fundit
për të mjerën vajzë. Varur ish e varfëra
me një lak në qafë që e kishte thurur
duk' i marrë penjët nga fustan' i saj;
tjetri kishte rënë përmbys mbi atë,
e mbante nga mezi, qante e vajtonte
dhe pse humbi nusen, shtratin nusëror,
po edhe për punën që kish bër' i ati.
Kur e pa Kreoni, thirri si i marrë,
mbrenda në varr hyri, ju afrua djalit
e duke rënkuar: „Ç'bën ashtu? i thotë,
„çfarë or i shkretë, të hipi në kokë?
Ç'mjerim të ka gjetur? Dil këtej, o bir,
dil, të lutem shumë, unë at' i yt
po të lutem shumë, po të bje ndër këmbë"
Djali e vështroi me një sy të egër,
nuk i dha përgjigje, në fytyr' e pështyri,

nxori shpejt e shpejt shpatën me dy teha
dhe me 'të në dorë, i u turr të jatit,
po ky menjëherë arriu e dolli.
Djal' i mjer' ahere çfryu kundër vetes:
me vrap zgjati krahët, nguli mu në brijnët
shpatën që e mbante; pastaj m'ato duar
të paralizuar' përqafoi vajzën
duk' e patur edhe mëndjen edhe ndjenjat;
gjakn' e kuq që nxori kur po hiqte shpirt,
i a hedh me forcë vajzës në fytyrë,
të asaj fytyre q'ishte krejt e zbehtë.
Dhe tashti i mjeri është shtrir' i vdekur
pranë vajzës vdekur dhe e bën' martesën
në pallat të Hadit, duk' çpallur botës
se për njerëzinë ësht' e keq' e madhe
mëndje-lehtësia.

(Del Euridiqi)

Skenë tretë

(Lajmëtari — Kori)

KORI

Ç'të mendosh, ç'të thuash? Ja kjo grua dolli
pa e çelur gojën; as një fjalë s'tha
të keq' a të mirë.

LAJMËTARI

Çuditem dhe unë, po më mban kjo shpresë:
Si dëgjoi ç'i ngjau birit saj fatkeq,
s'e gjeti me vënd të qaj, të vajtojë
përjashta pallatit, po në dhomat brenda
dhe me shërbëtoret t'ia nisë vajit
për zin' e tmeruar që i ra shtëpisë.
Është kjo një grua e urtë, me mënt
e pra s'më besohet të bëjë gabime.

KORI

Nuk dij; për mua heshtja e tepruar
është shënj, e keqe, si edhe vajtimet
që kalojnë masën.

LAJMËTARI

Le të hyjmë brenda, në pallat të sajë
që të marrim vesh, në se ajo fsheh
ndonjë gjë të keqe, në zemrën e sajë
fort të dëshpëruar; se, siç thua ti,
heshtja e tepruar s'është shënj' e mirë.

Skenë e katërtë

KORI

(Lajmëtari hyn në pallat dhe Kreoni hipi në skenë, duke mbajtur në duart kufomën e Emonit).

KORI

Ja ku po vjen mbreti dhe në dorë mban
— në më jepet lejë që ta thom këtë
provën e mëkatit q'e ka bërë vetë.
dhe jo ndonjë tjetër.

Skenë e pestë

(Kori — Kreoni)

KREONI

Strofë I.

Obobo!
Kok'e fortë
kok'e shkretë!
Ja ç'më sollë:
vdekjen vetë!
Pa na shihni,
ju o shokë,
ne të dy:
një fis jemi
e një gjak,
njëri vrasës
tjetri'i vrarë!

Obobo!
mëndj'e marrë!
Bir, o bir,
ububu,
i ri shkove
para kohe
ah medet!
ah medet!
Vdiqe, ike
dhe fajtori
s'je ti, bir,
po kjo kokë
krejt e marrë!

KORI

Medet!
Siç po shoh, të drejtën e mësove vonë.

KREONI

Oh! tashti marr vesh!
Po një hyj ahere më goditi rëndë,
më shtyri, më nxiti që të marr ca rrugë
tepër të këqija.

Gjith' ato gëzime që i kam shijuar
me shkelmë të fortë m'i përmbysi krejt.
Medet! mundime njerzish të kota!

(Hyn Lajmëtari)

Skenë e gjashtë

(Kori — Kreoni — Lajmëtari)

LAJMËTARI

Ç'mjerime të ranë mbi kokë o zot!
Ca i ke në duart, ca të tjera prapë
do shoç në shtëpi.

KREONI

Ç'është, more, prapë? ka nga të këqijat
më të keq' akoma?

LAJMËTARI

Vdiq, mbret, jotë shoqe nëna e këtij
q'është shtrir' i vdekur; tani shpejt e shkreta
vrau vetë vehten.

KREONI

Antristrofë I.

Oh! Oh;!
Ti, ambys'e Hadit
s'ke të ngopur kurrë!

Pse, moj, pse kërkon
krejt të më përpish?
Ti, or lajmëtar,
q'erdhe që më solle
lajme fort të hidhur,
ç'ësht kjo që thua?
Obobo;! Si erdhe
të i bjesh njeriut
q'ësht kufom' e gjallë!
Ç'thua, or djalë?
Ç'lajme tjetër sjell?
Oh! I mjeri unë,
gruaja më vdiq
vajti pranë djalit!

KORI

Mund ta shohësh vetë, se më s'është mbyllur
brenda në pallat

KREONI

Obobo!
I mjeri unë!
Ja po e shoh
me syt' e mi
të keqen tjetër
që më goditi.
Ç'fat vallë tjetër
që sot e tutje?
Po mbaj në dorë,
i shkreti unë,
djalin e vdekur;
përpara meje
shtrihet pa shpirt
grua e mjerë
nëna e djalit.
Oh! Nën' e mjerë,
Oh! Djal'i shkretë!

LAJMËTARI

E plagosur rëndë rreth altarit ra;
në fillim zu vajin për birin Megare
që kish rën' i vdekur me nder, me lavdi;

më pastaj mëshoi mallëkim më ty
për këtë të ligë që u bëre shkak,
sepse ty të quan vrasës të të birit.

KREONI

Strofë II.

Medet! Medet!
Jam i ngrirë,
i tmeruar,
i gurosur!
Si s'kam njeri
të ngulë shpatën
thell'e më thellë
në krahëror?
Un' i mjeri!
Ç'fund të ligë
paskam, oh!

LAJMËTARI

Për këto dy vdekje, kur po hiqte shpirt,
ty si shkakëtar, ty fajtor të quajti.

KREONI

Thuajmë si vallë vehten e ka vrarë?

LAJMËTARI

Si mësoi të keqen që i ngjau djalit,
ajo vetë shpatën në mëlçi e nguli.

KREONI

Ah! Medet! Medet!
ç'më ngjau mua
s'ka për ti ngjarë
asnjë njeriu.
Unë, o bir,
unë të vrava

me të vërtetë
unë kokë-forti.
Ju, shërbëtorë,
merrmëni shpejt,
hidhmëni jashtë
si një njeri
që s'jam i gjallë,
që jam kufomë,
një hiç, nj'asgjë.

KORI

Është një fitim ky që kërkon
— në rrjedh fitim dhe nga mynxyrat —
se sa m'e shkurtër, aqe m'e lehtë
bëhet e keqja

KREONI

Antristrofë II.

Ah! le të vijë,
të vijë vdekja,
që të më sjellë,
ditën e fundit!
ah! le të vijë,
që të mos shohin
më syt, e mij
dritën e djellit

KORI

Kjo i përket kohës së ardhme
dhe me këtë ka se kush merret;
për të tanishmet duhet menduar.

KREONI

Unë kërkova ç'më deshi zëmra.

KORI

Mos bëj më lutje; robi s'shpëton
nga fatkeqsia q'i cakton fati.

KREONI

Merrmëni,
hidhmëni!
Jam njeri
që s'vlej gjë.
I mjeri unë!
Unë pa dashje
të dy ju vrava:
ty biri im, ty grua ime!
I mjeri unë!
S'di nga të kthehem!
Të gjitha ç'kisha
m'iknë prej duarsh!
Një fat i keq
më ra në kokë!

Skenë e shtatë

KORI

Gjeja më parë për të qën'i lumur
ësht vërtet urtia. Hyjtë dhe hyjnorët
duhet respektuar; fjalët e mëdha
me plagët e rënda q'i sjellin krenarit
ia mësojn' urtinë, po në pleqëri.[1])

1) Krenarët dënohen rëndë për fjalët e mëdha (për mburrjet) dhe bëhen njerës të urtë, po vonë, kur plaken.

SHËNIME MITOLOGJIKE HISTORIKE, GJEOGRAFIKE E. T. J.

Amfioni: Bir i Zeusit dhe i Antiopes. Ky themeloi Tebén dhe u-bë mbret i saj. U-martua me vajzën e Tantalit Nioben, me të cilën lindi shtatë djem dhe shtatë vajza. Ka qënë një nga muzikantët më të ndëgjuar të vjetërsisë.

Antigona: Heroina e dramës, bija e Edipit e Iokastes.

Danaja: Bija e Akrisit, mbretit të qytetit Argos dhe të Euridiqit. I ati, nga frika e një orakulli, e mbylli në një kullë të remtë. Po këtu ajo lindi me Zeusin — që hyri në kullë ne formë shiu të artë — Perseun, me të cilin u hodh në det dhe shpëtoi në ishullin Serifos.

Dirke: Bija e Djellit dhe gruaja e Likut, mbretit të Tebës. Me qënë se iu suall keq Antiopes, gruas së parë të Likut, djemt' e kësaj së fundit, si urritnë, e lidhnë në brinjt' e një mëzati të tërbuar; ky e hoqi dhe e hodhi në një burim pranë Tebës, i cili mori emrin e saj.

Drianti: Mbret i Hedonëve në Thrakë dhe ati i Likurgut. Ky i fundit u verbua prej Zeusit, mbasi tallej me Bakhantet gjatë festave të Dionizit.

Emoni: Bir i Kreonit dhe i Euridiqit, i fejuari i Antigonës.

Eteokliu: Bir i Edipit dhe i Iokastes. Ky ndonëse i dha fjalën të vëllait Polinikut, se do të mbretëronin së bashku, më vonë e gënjeu dhe e rrëmbeu vetë pushtetin.

Poliniku ahere shkoi në Argos dhe kërkoi ndihmë nga i vjehri Adrasti, i cili bashkë me prisa të tjerë dhe me ushtri u turr kundër Tebës, po u thye dhe u shtrëngua të kthehet prapa, duke lënë të vrarë të birin dhe të dhëndërin Polinikun.

Kreoni: Bir i Menikeut dhe vëlla i Iokastes. Pas vdekjes së Lait dhe të bijve të Edipit hipi në fronin e Tebës.

Kastalia: Burim pranë orakullit të Delfit.

Korikia: Shpellë pranë Delfit.

Male Nisee: Male në Eube.

Lavdakidët: Stërnipërit e Lavdakut, nipit të Kadmit (themelonjësit të Tebës) dhe atit të Lait. Ky i fundit ish burri i Iokastes dhe ati i Edipit, i cili pa ditur vrau të jatin.

Menadet: Mbiemri i Bakhanteve, femrave që bënin si të tërbuara gjatë festës së Dionizit (Bakhut).

Ismeni: Lum i Beotisë në veri të Tebës.

Niobe: Bija e Tantalit dhe e Diës, grua e Amfionit, mbretit të Tebës. Me këtë lindi gjashtë djem dhe gjashtë vajza. Me qënë se një ditë u mburr se ajo kishte lindur më shumë fëmijë se sa Latona, nëna e Apollonit dhe e Artemidës, u zemërua La-

tona dhe urdhëroi të bijtë ta dënojnë Nioben krenare. Ahere Apolloni dhe Artemida u ranë me shigjeta dhe i vranë të dymbëdhjetë fëmijët e së mjerës Niobe. Kjo nga dëshpërimi u transformua në shkëmb dhe qan pa pushim.

Parnasi. Mal në Fodikë, mbi të cilin ishte ndërtuar faltorja e famëshme e Apollonit të Delfit.

Persefona: Bija e Zeusit dhe e Demetrës, gruaja e Hadit, perëndisë së nëndheshme.

Salmedesë: Qytet dhe port i Thrakës në bregdetin perëndimor të detit të Zi. Këtu Fineu, mbreti i këtij vëndi, duke u zënë besë shpifjeve të gruas së tij Ide, u a nxori sytë djemve të tij që kishte nga gruaja e parë. Për këtë krim je vetem u verbua dhe ay prej Arpieve, perëndeshave të stuhive, që shkatërronin ç'do gjë që preknin.

Sipili: Mal në Azin' e Vogël, në kufit' e Lidisë dhe Frigjisë; në këtë mal Nioba u transformua në shkëmb.

Tantali: Bir i Zeusit, mbret i Frigjisë dhe ati i Pelopit dhe i Niobes. Ky me qënë se therri të birin dhe mishin e tij ua paraqiti perëndive në sofrë (desh të provojë në se do të mundnin perënditë të njohin dinakërinë) u rrëzua poshtë te Hadi dhe këtu ndjente pa pushim etje të cilën nuk mundi kurrë ta shuajë, ndonëse rreth e rrotull kishte ujëra të kulluara dhe pemë të bukra.

Thyadet: Mbiemër i Bakhanteve, femrave që tërbonin në festat Dioniziake.

Tiresia: Shortari i famëshëm i vjetërsisë; ishte nga Teba dhe sipas mitologjisë, i verbër.

821.14'02-21 SOPH
7738-50

ÇMIMI 220 DIN.